



KOMISIONERI I PËRKOHSHËM PËR MEDIA
PRIVREMENI KOMESAR ZA MEDIJE
TEMPORARY MEDIA COMMISSIONER

***NJË ANALIZË E SJELLJES SË
TELEVIZIONEVE ME MBULIM
MBARË KOSOVAR***

(16-17 mars 2004)

***KONSTATIMET
DHE
REKOMANDIMET***

Prishtinë, prill 2004

Hyrje3

Pjesa I - Faktet Dhe Rekomandimet Lidhur Me Rtk-në

Përmbledhje7
Faktet Lidhur Me Radio -Televizionin E Kosovës 10
Konkluzionet Lidhur Me Radio -Televizionin E Kosovës 19
Rekomandimet Lidhur Me Radio -Televizionin E Kosovës.....24

Pjesa II - Faktet Dhe Rekomandimet Lidhur Me Ktv-në

Përmbledhje27
Faktet Lidhur Me Ktv -në28
Konkluzionet Lidhur Me Ktv - në32
Rekomandime Lidhur Me Ktv- në33

Pjesa III - Faktet Dhe Rekomandimet Lidhur Me Rtv 21

Përmbledhje35
Faktet Lidhur Me Tv 2136
Konkluzionet Lidhur Me Tv 2140
Rekomandimet Lidhur Me Tv 21 41

Shtojca - Transkriptet: Rtk-Ktv-Tv21 – 16-17 Mars

HYRJE

Në mbrëmjen e 16 Marsit, mediat kosovare raportuan për zhdukjen dhe mbytjen e supozuar të tre djemëve në lumin Ibër afër Mitrovicës. Brenda disa orëve, trupi i njërit djalë ishte gjetur. Përkundër apeleve të policisë së UNMIK-ut për maturi, raportet televizive në mënyrë të shpejtë dhe të sigurtë ia mveshen vdekjet një sulmi të serbëve, duke i dhënë këtij incidenti mundësinë e menjëhershme për të tendosur marrëdhëniet etnike tanimë të acaruar në Mitrovicë dhe gjetiu në Kosovë.

Në mëngjesin e ardhshëm një protestë e organizuar e nxënësve në Mitrovicë, e nxitur nga ky incident, u shndërrua në një protestë të dhunshme. Përleshjet në mes protestuesve dhe policisë e KFOR-it, u përhapen rrëmbimthi anembanë Kosovës me sulmet ndaj shtëpive, objekteve të komuniteteve dhe kishave serbe. Tri ditë më vonë, 19 persona vdiqën – 11 shqiptarë dhe 8 serbë, qindra u plagosën, disa qindra shtëpi të serbëve dhe minoriteteve tjera u dogjën ose u plaçkitën, 4,000 njerëz u strehuan në bazat e KFOR-it dhe në vende tjera të sigurta, kurse disa nga objektet e trashëguara historike dhe fetare të Kosovës u shndërruan në gërmadha të djegura.

Funksionarët e komunitetit ndërkombëtarë, përfshirë Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm, i kanë konsideruar mediat së paku pjesërisht përgjegjëse për këtë tragjedi. Ky raport shqyrton qëndrimet e mediave me ndikimin më të madh në Kosovë, tre transmetuesit televiziv me mbulim mbarë kosovar që momentalisht shikohen nga 70% e popullatës. Raporti jep edhe disa rekomandime të caktuara me qëllim të përmirësimit dhe paraqet konstatimet paraprake të shkeljeve të Kodit të Sjelljes të KPM-së për mediat elektronike.

Pjesa e parë e shqyrton qëndrimin e subjektit transmetues publik, RTK-së; Pjesa e dytë atë të Koha Vizionit; dhe Pjesa e tretë atë të TV 21.

Ne jemi përqëndruar në punën e tri televizioneve të cilat e mbulojnë tërë territorin e Kosovës, sepse ato janë burimet kryesore të lajmeve dhe informatave për kosovarët dhe në një masë të madhe përcaktojnë agjendën dhe tonin për mediat e tjera. Për hir të kohës, ne e kemi kufizuar këtë shqyrtim vetëm për periudhën kritike, duke filluar nga mbrëmja e 16 marsit dhe transmetimit të parë për vdekjet afër Çabrës e deri tek përhapja e dhunës nëpër tërë Kosovën më 17 mars.

Qëllimi ynë është që të identifikojmë çdo shkelje të Kodeve të Sjelljes për Media dhe të nxjerrim mësim konstruktive për mbështetjen dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të mediave në Kosovë.

Ne besojmë se çështjet kryesore për qëndrimet e mediave në Kosovë menjëherë para dhe gjatë dhunës që filloi me 17 mars janë:

(a) nëse, apo deri në çfarë shkalle mediat kanë përmbushur përgjegjësinë e tyre për të informuar publikun për ngjarjet ndërsa ulin elementet emocionale dhe nxitëse gjatë mbulimit të tyre në një minimum real; dhe

(b) nëse, dhe deri në çfarë shkalle mediat u përpoqën të shfrytëzojnë të gjitha mjetet në disponim, përfshirë deklaratat e zyrtarëve publik dhe analistëve ekspertë për të inkurajuar gjakftohtësinë.

Kërkimi për të identifikuar raportin specifik shkak - pasojë në mes veprimeve të mediave dhe reagimit të opinionit, nuk duket të jetë një rrugë frytëdhënëse e hulumtimit. Telefonat mobil mund të kenë luajtur fillimisht një rol po aq të rëndësishëm si edhe radio televizioni. Mbulimi i njëkohshëm i protestave serbe që ndodhnin në Çagllavicë, që rridhnin nga gjuajtja e një djaloshi serb prej një veture në lëvizje, ishte gjithashtu një faktor në nxitjen e zemërimit të opinionit.

Protestat dhe dhuna pasuese që shpërtheu në mëngjesin e 17 marsit në Mitrovicë, duket të kenë qenë deri në një masë të organizuara dhe të orkestruara, siç ishin sulmet në shtëpitë e serbëve dhe kishave.² Sidoqoftë, kjo nuk i arsyeton gabimet e gazetarisë. Gazetaria e matur, e qetë dhe e saktë, mund të kishte refuzuar elementet e organizuara si pretekst për trazira, plaçkitje dhe djegje dhe mund të ketë ndihmuar për uljen e nivelit dhe të intenzitetit të dhunës e cila ishte shfaqur.

Disa nga materialet më nxitëse të emituara nga televizionet kryesore më 17 mars u shpallën në formë të deklaratave të lëshuara nga liderët politikë dhe organizatat e Kosovës. Kryeministri Bajram Rexhepi ishte praktikisht i vetmi në mesin e liderëve kosovarë i cili në thirrjen për gjakftohësi, nuk e përcakton dot fajin për vdekjen e fëmijëve.³

² Vëzhguesit ndërkombëtarë kanë vërejtur se protestat e organizuara kanë filluar afër urës që lidh jugun dhe veriun e Mitrovicës me një marshim me rreth 1,000 nxënës, të shoqëruar nga mësuesit. Disa mbanin mbishkrime duke protestuar vrasjen e fëmijëve shqipëtarë. Një grup, siç duket i organizuar i rreth 100 të rinjëve u shfaq për të përcjellur marshin. Pasi që fëmijët u larguan nga ura, meshkujt u panë duke ia mësyer përgjatë urës, për të filluar konfrontimin me një numër të vogël të serbëve në anën veriore. Luftimi i egër dhe gjuajtjet me armë shpërthyen së shpejti. Intervista e KPM-së më 19 mars në Mitrovicë me përfaqësuesin e mediave të policisë së UNMIK-ut Barry Pollin dhe Tracy Becker dhe zëdhënësinë e UNMIK-ut Gyorgy Kakuk.

³ Deklaratat e lëshuara në pasditën e 17 marsit, përfshirë këtu edhe atë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), lidhin mbytjen e fëmijëve me “shërbimin sekret serb” dhe “organizatat kriminale serbe të kontrolluara nga Beogradi”. Ministri i Arsimit ka thënë se “mbytja e fëmijëve përkujton holokaustin”. Kryetari i Parlamentit Nexhat Daci, në deklaratën e dhënë për TV 21, apelon për

Karshi akuzave eksplozive, në gazetarinë profesionale nuk ka hapësirë për thashethëma ose hamendje për të vërtetën. *Nëse pjesa kryesore e ngjarjes është e pavërtetuar - për shembull, e vërteta e një deklarate për një sulm etnik – gazetarët duhet ta thonë atë.*

Ndikimi i *mundshëm* i mediave – në veçanti i televizionit- në situata shpërthyesë është megjithatë i njohur. Për këtë arsye është e domosdoshme që, kur tensionet etnike ekzistojnë, mediat elektronike dhe ato të shkruara, të jenë shumë të vetëdijshme për nevojën që të informojnë publikun e tyre duke minimizuar përmbajtjen emocionale të mbulimit dhe duke ofruar përmbajtje të matur dhe të besueshme. Saktësia faktike, toni dhe përmbajtja e raporteve që prekin çdo aspekt të etnicitetit, janë veçanërisht qenësore për të parandaluar subjektet transmetuese që të bëhen katalizatorë të dhunës.⁴ Karshi deklaratave eksplozive, në gazetarinë profesionale nuk ka hapësirë për thashethëma ose hamendje për të vërtetën. *Nëse pjesa kryesore e ngjarjes është e pavërtetuar- për shembull, e vërteta e një deklarate për një sulm etnik – gazetarët duhet ta thonë atë.*

Prishtinë, 23 prill 2004

Robert Gillette
Komisioneri i Përkohshëm për Media

gjakftohtësi dhe thërret popullin të jetë syqelur ndaj raporteve të pasakta të mediave, por më vonë thotë për RTK-në se “skenat e ndjekjes me qenë më përkujtojnë të kaluarën e fashizmit”. Në referimin e qartë për Mitrovicën, ai shton se “denacifikimi i vendit ende nuk është bërë”.

⁴ Neni 2.2 i Kodit të Sjelljes së KPM-së për mediat elektronike thotë: “Emetuesit nuk do të transmetojnë asnjë material që nxitë krim ose aktivitete kriminale, ose që përmban rrezikun e shkaktimit të dëmit, që mund të jetë vdekje, lëndim, dëmtim i pronës apo ndonjë formë tjetër e dhunës”.



KOMISIONERI I PRËKOHSHËM PËR MEDIA
PRIVREMENTI KOMESAR ZA MEDIJE
TEMPORARY MEDIA COMMISSIONER

PJESA I

FAKTET DHE REKOMANDIMET LIDHUR ME RTK-NË

PËRMBLEDHJE

1. Mbytja e supozuar e tre fëmijëve afër fshatit Çabër, e raportuar nga RTK, KTV dhe TV 21 në mbrëmjen e 16 marsit, ishte lajmi kryesor, i cili meritonte mbulim medial të spikatur por edhe të saktë dhe të kujdesshëm pavarësisht nga rrethanat. Pohimi - ende i paverifikuar - i një elementi etnik në incident kërkonte një trajtim shumë të kujdesshëm dhe faktik të ngjarjes.
2. Intervistat televizive me një të mbijetuar të traumatizuar 14 vjeçar ngritën çështje serioze etike. Është pothuajse e vërtetë se sikur djali të mos ishte intervistuar, pretendimet për përzierjen e serbëve do të bëheshin të njohura shpejt. Gazetarët e matur megjithatë, do t'i kishin dhënë së paku peshë të njëjtë deklaratave të policisë se nuk kishte (dhe ende nuk ka) dëshmi të pavarura për të mbështetur këto pohime. Gazetarët e matur do të nënvizonin pasigurinë e asaj çfarë faktikisht ka ndodhur me katër djemtë. Gazetarët e matur do të kishin kërkuar të nxjerrin detaje sqaruese nga djali.
3. Me përjashtim të raporteve të shkurtëra nga Mitrovica nga një korrespondent herët në mbrëmjen e 16 marsit, RTK-ja nuk ka shfaqur një maturi të tillë. Gjatë tërë mbrëmjes së 16 marsit, RTK-ja i ka minimizuar dhe përfundimisht thjeshtë i ka injoruar apelet e policisë për maturi në çështjen qenësore të ngatërrimit të serbëve. Në vend të kësaj, RTK i ka dhënë besim të pajustificuar rrëfimit konfuz dhe në disa aspekte kontradiktor dhe të papërfunduar të vogëlushit të katërt që ka mbijetuar për gjoja se përzierjen e fshatarëve serbë. Vonë në mbrëmjen e 16 marsit, RTK-ja ka kaluar madje prej një baze të dyshimtë të një storie tek pohimi kategorik se serbët kanë sulmuar fëmijët dhe kanë shkaktuar mbytjen e tyre.
4. Përderisa raportimi i stories nga RTK shkonte kah pohimi kategorik për përgjegjësinë e serbëve për vdekjet, pa u bazuar në asnjë informatë të re, tregimi i rrëfyer nga vogëlushi që kishte mbijetuar, kishte marrë kahje të kundërt. Në intervistën e tij të dytë, në natën e 16 marsit, intervistë e dhënë për KTV-në, vogëlushi sqaroi se ai dhe shokët e tij kanë ikur jo nga njerëzit - me gjasë fshatarë serbë- por nga një qen, çështje të cilën ai e ka bërë edhe më të qartë në intervistën e tretë, të emituar nga TV 21 në mbrëmjen e 17 marsit.
5. Duke u shmangur nga baza e dobët faktike e stories, RTK vazhdoi gjatë natës së 16 marsit të bazohet në pohimet e saja të pambështetura për sulmin e serbëve për të krijuar një kontekst mashtrues të rrezikshëm dhe nxitës për mbytjet, sipas të cilit tre vogëlushët ishin thjeshtë viktimat e fundit në luftën e shqiptarëve të Kosovës për liri nga shtypja serbe. RTK-

ja e emitoi pothuajse vazhdimisht përmes lajmit të titruar dhe edicioneve speciale, duke krijuar një atmosferë eksplozive të histerisë patriotike përreth kësaj tragjedie e cila është pasqyruar në gazetatat e të nesërme dhe deklaratat e figurave kryesore politike të cilët i bashkuan thirrjet për qetësi në pasditën e 17 marsit me sulmet “kriminelët serbë” dhe madje agjentët e zbulimit të Beogradit për të cilët supozohej se kanë vrarë fëmijët.

6. RTK e vetmja, në mesin e tri stacioneve televizive me mbulim mbarë kosovar, në natën e 16 – 17 marsit ka krijuar një kontekst emocional dhe politik për ngjarjen përmes intervistave të cilat kategorikisht ua mveshnin vdekjen e fëmijëve “banditëve serbë” dhe “hordhive çetnike serbe”, duke mos u bazuar në asnjë dëshmi faktike. Një prezantues i RTK-së i shtoi atmosferës së fatkeqësisë që po zhvillohej me pyetjet e përsëritura që u bënte korrespondentëve për atë se si reagonte popullata ndaj asaj që ishte marrë si fakt i kryer i sulmit serb. Një korrespondent i RTK-së, duke përsëritur deklaratën për ‘sulmin serb’ pa ndonjë kualifikim dhe pa iu referuar thirrjeve të policisë për maturi, u përgjigj se një ‘ revoltë’ sa vinte po rritej në mesin e banorëve në rajonin e Mitrovicës, e drejtuar kundër policisë së UNMIK–ut që në rradhët e veta ka policë serbë.
7. Me këto dhe veprime të tjera, RTK u bë kryesisht, nëse jo krejtësisht, përgjegjëse në mesin e tri stacioneve televizive me mbulim mbarë kosovar për transformimin e lajmit lidhur me ngjarjen tragjike të vdekjes së tre fëmijëve, në një dramë të rrezikshme politike. Sikur të kërkohej të theksohej kjo ngjarje si një katastrofë kombëtare, madje para se të bëhej e tillë, RTK ndërpreu reklamën në natën e 16 marsit dhe dikur vonë në mbrëmje, zëvendësoi shumicën e programit të saj të rregullt me muzikë të zymtë klasike. Për dallim, KTV dhe TV 21 vepruan kështu vetëm pas shumë orësh, kur katastrofa ndodhi me të vërtetë me shpërthimin e trazirave dhe përhapjen e rrëmbyeshme të tyre në mëngjesin dhe në pasditën e 17 marsit.
8. Shkathtësitë dhe guximi i shumicës së stafit të lajmeve të RTK-së qëndron në kontrast me punën e menagjmentit të RTK-së – vlerësimi i të cilëve për lajmet ishte shpesh, nëse jo vazhdimisht, i shënuar me një mospërfillje të pamatur për rrezikun e nxitjes dhe acarimit të trazirave qytetare.
9. Gabimi fundamental i menagjmentit të lartë të RTK_së dhe i disa korrespondentëve – por jo i të gjithëve- ishte lejjimi çfarë dukej të ketë qenë l një ndjenje të shtrembëruar të patriotizmit që të mbizotërojë mbi profesionalizmin.
10. Kur mbulimi i dhunës filloi më 17 mars, RTK dhe KTV shfaqën pak mirëkuptim për dallimin në mes të raportimit të lajmeve faktike dhe sensacionalizmit të tyre me segmentet e zgjatura dramatike “pa koment”

të inçizimeve të konflikteve të dhunshme dhe skenave kaotike të viktimave të përgjakura të sjellura në spital. RTK, e vetmja në mesin e subjekteve transmetuese, në mënyrë mospërfillëse kundërshtoi apelet e KPM për të “ulur temperaturën emocionale” të raportimit të saj dhe të ofrojë lajme të plota dhe faktike.

FAKTET LIDHUR ME RADIO-TELEVIZIONIN E KOSOVËS

1. Sipas menaxherëve të RTK-së, RTK-ja ka mësuar për herë të parë për ngjarjen për të cilën është kuptuar se përfshinë mbytjen e tre fëmijëve në rajonin e Çabrës, me mundësi të ngatërrimit të serbëve, nga telefonatat e qytetarëve të zakonshëm, në mes orës 18:30 dhe 19:00, me 16 mars.⁵ RTK i ka telefonuar zëdhënëses së UNMIK-ut Tracy Becker, e cila pas kontrollimit të raportit ka thirrur menjëherë pas orës 19:00 për të informuar se tre fëmijë shqiptarë sipas raporteve janë të zhdukur në lum. Znj. Becker përkujton se: “Unë kam lutur posaçërisht RTK-në të mos u referohen serbëve sepse kjo do të ngris tensionet etnike” pasi që elementi etnik i stories nuk ishte i konfirmuar apo i dëshmuar.
2. Duke kërkuar informata të mëtutjeshme, RTK-ja u telefonoi kontakteve në Çabër sikurse dhe z. Halit Baranit, i njohur, dhe për Komunitetin Ndërkombëtar, aktivist kontraverz për të drejtat e njeriut në Mitrovicë.⁶ Raportohet se z. Barani “nuk dinte asgjë” lidhur me ngjarjen, por theksoi se sapo kishte ndodhur një eksplozim në rajonin e tre rrokaqiejve në Mitrovicë.⁷
3. Në lajmet kryesore të mbrëmjes më 19:30, prezantuesi i RTK-së lexoi një tekst të shkurtër duke thënë se policia po kërkon tre fëmijët e zhdukur përgjatë Ibrit, dhe se zhdukja e tyre mund të ketë qenë shkaktuar për shkak të grindjeve në mes të serbëve dhe shqiptarëve, duke injoruar kërkesën e zëdhënëses së policisë së UNMIK-ut për maturi. Ekipi televiziv arrin në Çabër rreth orës 20:00 që të bëjë një intervistë me vogëlushin 14 vjeçar të mbijetuar. Policia e pa z. Baranin në Çabër në ora 21:30, duke i përcjellur gazetarët dhe duke marrë pjesë në konferencën për shtyp të policisë së UNMIK-ut. Nuk dihet nëse ai ka ndikuar në rrëfimin që ka dhënë vogëlushi.
4. Duke filluar rreth 20:30 të mbrëmjes së 16 marsit RTK zuri të emetojë një lajm përmes titrave në ekran, duke i njoftuar shikuesit për incidentin dhe duke iu premtuar lajme speciale të cilat do të emetohen rreth orës 22:30. “Bazuar në informacionet që kemi deri më tani, ata janë viktimat të sulmit serb në fshatin Çabër”, thotë mesazhi: **(shih transkriptin 1)**.
5. Në Mitrovicë, pasi që mediat ishin mbledhur për të mbuluar kërkimet për gjetjen e fëmijëve të zhdukur gjatë mbrëmjes së 16 marsit, policia e UNMIK-ut deklaroi se ata u kanë shpjeguar vazhdimisht gazetarëve të RTK-së dhe mediave të tjera se asnjë informatë nuk është e gatshme për ta konfirmuar

⁵ Intervistë grupore më 26 mars me udhëheqësit e RTK-së Astrit Salihu, zëvendës drejtori i përgjithshëm; Liridon Cahani, drejtor i RTK-së; Mufail Limani, kryeredaktor i lajmeve në RTK; Elvana Prekazi, këshilltar juridik i RTK-së; dhe Rafaela Prifti, përfaqësuese për marrëdhënie publike.

⁶ Kryesuesi i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Mitrovicë

⁷ Shih shënimin 4; Mufail Limani.

apo dëshmuar rrëfimin e djaloshit të mbijetuar se fshatarët serbë dhe qeni kishin qenë të përfshirë në incident. Zëdhënësja e policisë Becker tha: “Unë bisedova me RTK dhe KTV jo më pak se tri here dhe thash, mos u ngutni me konkluzione. Nëse është e vërtetë ne do t’ju tregojmë”. Ajo shtoi: unë mora telefonata nga Associated Press, Reuters etj. Të gjithëve ua thashë të njëjtën gjë: Ne nuk mund ta konfirmojmë këtë rrëfim”.

6. Zëdhënësi i UNMIK-ut, Gyorgy Kakuk tha se gazetarët, thjeshtë nuk po i dëgjonin thirrjet paralajmëruese të ndërkombëtarëve të cilët ishin në vendngjarje. “Ne e kemi ndier atë mbrëmje se nuk kishte shpresë që mesazhi të depërtonte.”
7. Zonja Becker krijoi një hapësirë për gazetarët ku ata mund të filmonin dhe të mirrnin raporte, si dhe t’u shmangeshin ndërhyrjes në ekipet kërkuese përgjatë brigjeve të lumit. Përfaqësuesi i UNMIK-ut tha se posaçërisht ekipi i RTK-së nuk bashkëpunonte. Përcillte në mënyrë agresive dhe kundër urdhërit të policisë ekipet kërkuese dhe përpiqej ta xhironte trupin e fëmiut të parë të nxjerrë nga lumi në orët e vona të natës. Znj. Becker tha për ekipin e RTK-së: “Ata gati u arrestuan. Unë këmbëngula që ata të mos përcillnin kërkuesit, të mos xhirohej trupi i fëmiu pasi që ne e konsideronim këtë si vend të krimit. Por ne e gjetëm RTK-në pranë trupit të fëmiut, duke u munduar ta xhironin atë. Gjatë tërë natës ata nuk bashkëpunuan fare.”
8. RTK-ja emtoi raportin e lajmeve speciale në 22:28, që ishte faktik dhe mjaft i matur. Gazetarja, nga vendi i ngjarjes në Mitrovicë, Rozafa Metaj, raportoi me maturi për kërkimin e trupave të tre fëmijëve të zhdukur, kur tha: “ranë në lum” afër Çabrës. Ajo nuk e fajësoi askënd. Deklarata tonike, 12 sekondëshe e dhënë nga znj. Becker, e cila citohej në përkthim siç vijon: “Fillimisht atje ndëgjoheshin zëra se incidenti ishte i motivuar etnikisht, por për momentin ne nuk kemi këso informatash dhe nuk mund ta konfirmojmë këtë”. **(Shih transkriptin 2).**
9. Pastaj RTK-ja emtoi intervistën dy minutëshe me djaloshin e mbijetuar, Fitim Veselin. I kërrusur dhe i përmbajtur, i ulur në shtrat në shtëpinë e tij në Çabër, ai përkujtonte se si ai, kushërinjtë dhe vëllau i tij ishin duke shëtitur pranë lumit atë pasdite “kur disa serbë me një qen, përshembull, na shanë nga shtëpia. Ne i shikuam ata, dhe unë mund t’i identifikoj ata nëse i shoh dhe unë e di shtëpinë e tyre dhe ne u munduam të ikim por nuk mundëm sepse ishim afër lumit”. Ai përshkruajti në detaje shqetësuese se si ai u përpoq ta barte vëllaun e tij në shpindë derisa po përpiqeshin ta kalonin lumin me dy vogëlushë të tjerë, por rryma e lumit i rrëmbeu ata. *Ai nuk tha se se serbët i kanë ndjekur ata në lum.*
10. Gazetari i RTK-së, duke folur me butësi, nuk u përpyk të nxjerrë detaje shtesë nga vogëlushi. Dy orë më vonë, në një intervistë me KTV-në, vogëlushi do të sqarojë se ai dhe djemtë e tjerë, në fakt u friguan nga qeni dhe jo nga

serbët, të cilët ishin shumë larg, tha ai, që t'u shkaktojnë atyre ndonjë të keqe. Në intervistën e tretë televizive, të filmuar ditën e nesërme nga TV 21, në vendin e sulmit të supozuar, djaloshi do të tregonte shtëpinë e largët - siç duket së paku 100 metra larg - ku ai tha, " pasiqë ne nuk i pamë serbët, ata na shajtën nga ajo shtëpi dhe më pas ne i pamë ata dhe filluam të vrapojmë, por ata na e lëshuan qenin, qeni ishte shumë i shpejtë dhe nuk do të mund të iknim prej tij" Ai nuk ishte pyetur se a mendonte se qeni ishte "lëshuar", apo vraponte vetvetiu pas djelmoshave.⁸⁷

11. Politizimi i mbytjeve fillon në RTK me orarin e rregullt të BLIC programit të lajmeve në mbrëmje, i cili u emetua rreth orës 23:15. Duke filluar lajmet, prezantuesi në mënyrë kategorike deklaroi se tre djemtë e zhdukur ishin "viktima të sulmit nga një grup serbësh", pohim ky i cili injoronte apelin e policisë për maturi dhe tejkalonte atë që i mbijetuari kishte thënë. **[Shih transkriptin 3]**
12. Korrespondenti Petrit Musolli përsërit deklaratën duke e shëndrruar supozimin në fakt : "Policia, KFOR-i dhe TMK-ja ende nuk i kanë gjetur trupat e tre fëmijëve të zhdukur në lumin Ibër, të cilët kishin rënë në të ndërsa po ndiqeshin nga një grup i serbëve". Duke injoruar apo i pavetëdijshëm për qëndrimin e policisë së UNMIK-ut se rrëfimi i djaloshtit të mbijetuar mbetet i paverifikuar, korrespondenti shtoi: "Deri më tani, policia nuk shpjegoi dhe nuk dha më shumë informacione se sa rrëfimi i Fitim Veselit, të mbijetuarit të vetëm. Të gjitha informacionet që kishin, janë nga rrëfimi i Fitim Veselit, tha policia". Në këtë deklaratë nënkuptohet se djaloshi kishte thënë se kishte qenë i ndjekur në lum nga serbët, çka ai nuk kishte thënë dhe dështoi të bartë mesazhin të cilin policia përpigj ta komunikonte: Se atje nuk kishte dëshmi për ta mbështetur, e të mos flasim për verifikim të rrëfimit të treguar nga djaloshi i traumatizuar.
13. Prezentuesja e BLIC-it, e cila duket ta ketë kuptuar potencialin eksplozues të rrëfimit, pyeti korrespondentin Musolli në Mitrovicë: "Si është situata në Mitrovicë, a është nën kontrollë, çfarë është reagimi i qytetarëve?" dhe e përsërit këtë pyetje edhe dy herë gjatë emetimit të lajmit. Korrespondenti, përsëri duke e potencuar "sulmin" e serbëve ndaj fëmijëve, u përgjigj se, "Situata për momentin është e qetë" dhe se " pothuajse të gjithë qytetarët janë nisur drejt Çabrës, derisa policia ka filluar të kontrollojë rrugët "e posaçërisht ato afër shtëpive të serbëve prej nga janë sulmuar fëmijët, të cilët janë detyruar të kërcejnë në lum për të shpëtuar". Policia ka marrë raporte se

⁸ Kur incidenti i supozuar ka ndodhur, dy djelmoshat tjerë shoqëronin katër të tjerët të cilët u futën në lum, por siç thuhet, ata dy e lëshuan vendin e ngjarjes duke shkuar rrugës tjetër. Nuk dihet të jetë bërë ndonjë intervistë me ta nga ndonjë media. Policia e bëri këtë, por raportohet se dy djelmoshat pohojnë se nuk kanë ndëgjuar dhe nuk kanë parë asgjë. Policia më pas kishte vizituar shtëpinë të cilën e kishte treguar djaloshi i mbijetuar, por thonë se nuk kanë gjetur ndonjë dëshmi për qentë apo fshatarët, e që përputhet me përshkrimin që dha djaloshi.

një grup qytetarësh janë rrugës për në Çabër, por referimi në “pothuajse të gjithë qytetarët” ishte qartazi një egzagjerim i madh.⁹

14. Pastaj vazhdoi përsëritja e intervistës me djaloshin e mbijetuar, së bashku me 12 sekonda inserte tonike nga Becker, e cila, në përkthim, dha një version tejet të dobët të mesazhit paralajmërues të cilin ajo mendohej ta përcjellë. Edhe pse atë natë ajo dha së paku edhe dy deklaratat tjera, RTK-ja nuk i shfrytëzoi ato.
15. Duke u përgatitur për lajmet e BLIC-it në orën 23:00, menaxherët e RTK-së ftuan z. Baranin të paraqitet në studio si mysafir në emision të drejtpërdrejtë. Z. Salihu, zëvendës drejtor i RTK-së tha se ata e bënë këtë pasiqë e konsideruan atë të jetë “neutral”, objektiv, aktivist i respektuar për të drejtat e njeriut, dhe se emisioni BLIC gjithmonë emeton intervista të shkurtëra në studio me persona ku diskutohet për ngjarjet më kryesore të ditës, siç ishte mbytja e vogëlushve në ujë. Policia e UNMIK-ut e konsideron z. Baranin sipërfaqësor në qasjen e tij në hetimet lidhur me të drejtat e njeriut, i pakujdesshëm me faktet e tija dhe i padurueshëm për të publikuar çfarëdo gabimi të supozuar të bërë nga serbët. Vetëm RTK-ja emtoi intervistën me z. Baranin më 16 dhe 17 mars.
16. Menaxherët e RTK-së kanë bërë të ditur se përderisa Blic ishte duke u përgatitur, ata ishin në dijeni se tensionet etnike dhe politike ishin duke u rritur jashtëzakonisht shpejtë në Kosovë.¹⁰ Ata kanë vërejtur se protestat kishin shpërthyer që nga hedhja e bombës para shtëpisë së Kryetarit Rugova në Prishtinë. Në ditën e njëjtë, më 16 mars, një konfrontim ishte duke u zhvilluar në mes të shqiptarëve dhe serbëve në Çagllavicë- bllokimin e fundit të rrugës kryesore për të protestuar ndaj plagosjes së një të riu serb nga dita e mëparshme. Veç kësaj, veteranët e UÇK-së parakaluan në disa vende - RTK-ja jep numrin 27 pa i përcaktuar ato - për të protestuar kundër arrestimeve të veteranëve të UÇK-së të dyshuar për pjesëmarrje në krime lufte.
17. Redaktori i lajmeve të RTK-së, Limani, tha se ai ishte tepër i brengosur se ngjarja në Çabër do të mund të shkaktojë konflikt etnik në rajonin e Mitrovicës prandaj i ka telefonuar Kryeministrit Bajram Rexhepi të martën mbrëma rreth orës 22:00 për ta paralajmëruar atë për situatën e zhvilluar.
18. Pas intervistës me vogëlushin në Blic, prezantuesja i drejtohet z. Baranit i cili qëndronte pranë saj në studion në Prishtinë dhe e pyet se çfarë mund t'i shtoj stories. Z. Barani përshkroi vdekjen e djelmoshave si sulmin e fundit nga

⁹ Shih shënimin 2. Tracy Becker përkujton: “ U ktheva prapë tek ekipet televizive posaqërisht që t'i adresoj thashethëmet për disa shqiptarëve që po vinin në Çabër për të krijuar probleme. Unë shpjegova se njerëzit duhet të jenë të qetë, të qëndrojnë në shtëpitë e tyre dhe të lejojnë policinë të përqëndrohet në gjetjen e fëmijëve të zhdukur në vend se të shpërndajë grupet e njerëzve dhe të mirret me kontrollimin e turmës. Përsërita se thashethëmet për përfshirjen e serbëve ishin të pabaza. i luta ta emetojnë këtë informatë, të cilën gjë qartazi ata nuk e bënë.

¹⁰ shih shënimin 4

shumë “sulme” të “banditëve serbë” kundër shqiptarëve të Kosovës, dhe lidhi mbytjen në Çabër me protestat në Çagllavicë, të cilat, ai dukej se sugjeronte, mund të jenë provokim serb. Ai nuk përmendi arsyen specifike për protestat serbe, gjuajtjen e një të riu serb.¹¹

- 19.Z. Barani në këtë mënyrë e politizoi vdekjen ende të pazbardhur të djelmoshave me fjalë nxitëse. Prezantuesja e Blicit- dhe producenti i programit, i cili duhej të ishte në gjendje të komunikojë me të përmes dëgjuesës,- dështoi t'i sfidojë karakterizimet e z.Baranit për incidentin si një akt të “banditëve serbë”. Përshkrimet e tij për incidentin u lejuan të mbesin edhe gjatë emitimit të ri të RTK-së rreth orës 01:00 më 17 mars, ndërsa ai pastaj vazhdojë t'i plotësojë ato në intervistën e dytë të emituar gjysmë ore më vonë. *Ne nuk jemi në dijeni që RTK-ja ndonjëherë rishikoi çështjen se çfarë me të vërtetë kishte ndodhur në Çabër.*
20. Storia e mbytjes në Mitrovicë është vazhduar në edicionin e Blicit më 16 mars me dy ngjarje të cilat lajmeve i shtuan një përmbajtje të fuqishme emocionale. Njëra prej tyre ishte raporti për të cilin RTK-ja thoshte se ishte “ dy orë e protestave gjithëpopullore” në 27 lokacione në Kosovë të ish-luftëtarëve të UÇK-së të dyshuar për krime lufte. Storjen filmike të protestuesve në Prishtinë, prezantuesi i RTK-së tha se disa nga parullat i drejtoheshin UNMIK-ut, duke përfshirë disa në të cilat shkruhej: “ Stop administrimit serb-UNMIK”. Storia e tretë me inçizime nga vendi i ngjarjes raporton për rritjen e dhunës në Çagllavicë, lëndimet e një polici të UNMIK-ut dhe dëmtimit të një veture. Policia, Kryetari Rugova, dhe Ministri Rexhepi janë cituar duke dënuar plagosjen e një të riu serb që ndezi protestat.
21. Blici më pastaj u zhvendos në një sërë storjesh të lehta politike që normalisht përmbajnë pjesën më të madhe të lajmeve, duke përfshirë edhe vizitën e liderit të PDK-së Hashim Thaçit në Washington, mosmarrëveshjen politike në mes të Ministrisë të financave dhe atij të Shërbimeve Publike, dhe storien e takimit të OJQ-ve lidhur me diskutimin për mbledhjen e donacioneve.
22. Pas Blicit, RTK emitoi lajmin tekstual lidhur me gjetjen e trupit të njërit nga vogëlushët e zhdukur dhe i paralajmëroi storien me informatat e fundit : “Trupi i 12 vjeçarit është gjetur një kilometër prej vendit të ngjarjes. Edicioni Special në orën 01:00.” Edicioni Special përsërit storien e mëparshme duke shtuar lajmin e gjetjes së një trupi. Nuk ka përsëritur intervistën e shkurtër me z. Baranin. RTK as që ka sfiduar karakterizimet e tij për ngjarjen si vepër të “

¹¹ Nga transkripti dhe përkthimi i KPM-së të komentit të z.Barani: “ Ne jemi mësuar me këta banditë serb. Përveç kësaj, sonte në 19:17 në lagjen “17 shtatori” ata hodhën një bombë afër tre rrokaqejve (në Mitrovicë). Ne mendojmë se është hakmarrje për rastin i cili ndodhi në Çagllavicë, rast i cili tregon se çfarë serbë janë në gjendje të bëjnë serbët kur situata është duke u qetësuar në Kosovë. Ata janë në gjendje të bëjnë çdo gjë. Nuk është në favor të tyre të kenë një Kosovë të qetë”. Policia e UNMIK-ut njofton se nuk ka dëshmi për të mbështetur pohimet e z. Baranit për përgjegjësinë e serbëve për shpërthimin e granatës.

banditëve serbë” dhe as që i ka shtuar një notë maturie apo skepticizëm ngjarjes në fjalë. **[Shih transkriptin 4]**

23. Në 01:35, RTK ka emituar lajmet më të reja të cilat filluan me raportin e ri të Petrit Musollit, i cili përsëri injoroi lutjet e policisë për maturi dhe storien e djaloshit të mbijetuar që ta vërtetojë kategorikisht se fëmijët kanë qenë “të ndjekur nga një grup serbësh të cilët i ndërsyen qentë” dhe “në pamundësi për t’ju ikur këtyre serbëve, kanë qenë të detyruar të hidhen në lumin Ibër”. Në këtë edicion të ri të lajmeve ishte hequr deklarata e Becker-it, duke e lënë atë pa këndvështrimin e policisë. **[Shih transkriptin 5]**
24. Raporti i z. Musolli ia lëshoi rradhën intervistës tjetër me z. Baranin, këtë herë jo në studio por në bregun me rërë të lumit afër fshatit Çabër. Z. Barani përsëriti referimin e tij “banditët serbë” dhe më tutje vazhdoi të spekulojë se popullata lokale mund të pritet të reagojë. Ai veproi në atë mënyrë sa që efektivisht u bëri thirrje kosovarëve që t’a shprehin pakënaqësinë e tyre, duke sugjeruar se djelmoshat ishin mbytur nga serbët si hakmarrje për plagosjen e një serbi në Çagllavicë: “Është i kuptueshëm cili do të jetë reagimi jo vetëm i banorëve të Çabërës të cilëve u ka ndodhur kjo tragjedi, por edhe atyre të cilëve kjo nuk u ka ndodhur, por që kanë dëgjuar për atë. Natyrisht se ata janë të indinjuar, përderisa ne mund të supozojmë se kjo është hakmarrje kundër plagosjes së një serbi në Çagllavicë- ai ishte një “inskenim” për çka ata kanë afinitet. Çdo herë kur situata fillon të stabilizohet në Kosovë, ata gjejnë mënyra të ndryshme të bëjnë gjëra të këtilla për ta destabilizuar situatën.
25. RTK-ja nuk ka emituar asnjë kundërvënie apo mendim alternativ ndaj spekulimeve nxitëse të z. Baranit, atëherë apo më vonë. Përkundrazi, një orë më vonë, në 02:36 më 17 mars, RTK-ja emitoi më tutje lajme speciale me z. Baranin. Këtë herë ai nuk tha asgjë, por, duke qëndruar pranë lumit ai e mbante për dore z. Zaim Deliu, babain zemërthyer të njërit nga djelmoshat. Ashtu si z. Barani, z. Deliu ishte i sigurtë se ai e dinte se çfarë kishte ndodhur. Ai tha, “ Djali im, në këtë ditë të kobshme, u gjend i vdekur nga hordhitë çetnike serbe... ata e mbytën atë në mënyrën më mizore, duke e detyruar atë të hidhet në lum”. **[Shih transkriptin 6]**
26. Në orën 06:00 më 17 mars, një mesazh i titruar i RTK-së vazhdoi të citonte gabimisht të mbijetuarin: “Fitim Veseli, i mbijetuari i ngjarjes, ka thënë se ata ishin të ndjekur me një qen nga një grup serbësh nga Mitrovica veriore”. **[Shih transkriptin 7]**
27. Menjëherë pas orës 07:00, RTK-ja përsëriti lajmin për vdekjen e djelmoshave tri herë në edicionet pasuese, çdo herë duke përfshirë fragmente të intervistës me djaloshin e mbijetuar, dhe asnjëhere nuk janë transmetuar paralajmerimet paraprake të policisë për maturi të një nate të mëparshme në Mitrovicë. Intervistat me z. Barani dhe z. Deliu nuk janë përsëritur më.

28. Të mërkurën në orën 11:52, më 17 mars titrat gjatë kohës së transmetimit të orkestrës simfonike lajmëruan për shpërthimin e dhunës në mes të protestuesve dhe policisë në Mitrovicë. Edicioni special i lajmeve të reja pasoi duke u zëvendësuar me titra të reja gjatë kohës kur transmetohej muzikë klasike, për të vënë modelin për pjesën më të madhe të mbulimit të asaj dite. Storja tanimë spostohet në dhunën që zhvillohet ndërsa ngjarja për atë se çfarë në të vërtetë ka ndodhur me djelmoshat, lihet pas dore.
29. Në 12: 28, koncerti i inçizuar simfonik ka mbaruar dhe RTK vazhdon me titrat në pjesën e epërme të ekranit duke emituar lajmet lidhur me rritjen e dhunës. Nën këto titra, redaktorët e RTK-së zgjodhën të emitojnë inçizime simbolizuese politike, sikur të dëshironin të thërrisnin shikuesit nga mbarë Kosova për të përkujtuar patriotizmin e tyre në këtë moment të caktuar. Inçizimi ishte një filmim i shkurtër, insert i zgjedhur nga koncerti i verës së kaluar në Prishtinë kushtuar Fatmir Limës, një luftëtar i UÇK,-së i konsideruar si hero nga shumë kosovarë, kurse nga komuniteti ndërkombëtar kriminel i mundshëm luftime. Ai tani pret gjykimin në Hagë. Derisa titrat përcjellnin lajmet për dhunën në Mitrovicë, fytyra e z. Limajt u paraqit me fjalët, “Lirimi yt, liria jonë”, e përcjellur me fëmijët duke kënduar dhe me përshëndetje të tjera muzikore ndaj Limajt në 22 minutat vijuese. Kjo ishte hyrja e RTK në lajmet e para speciale në ditën e mbulimit të dhunës në Mitrovicë.
30. Me kalimin e pasditës, RTK-ja emitonte një sërë raportesh telefonike për shpërthimin e dhunës në Mitrovicë, duke përfshirë edhe raporte “për të shtëna armësh nga Mitrovica veriore”, duke vazhduar me marshin e fëmijëve në drejtim të Çabres, për të protestuar për atë që tani në mënyrë të qartë ishte paraqitur si vrasje e tre fëmijëve shqiptarë nga serbët. Në raportin nga Çabra, RTK-ja vazhdonte ende me shënime të z. Baranit. Nuk kishte përpjekje të mëtutjeshme për të sqaruar se çfarë në të vërtetë kishte ndodhur apo nuk kishte ndodhur me fëmijët e vdekur, dhe nuk kishte tentime të sugjerohej, ashtu siç BBC-ja pas pak raportoi nga Kosova, se fëmijët janë fundosur “deri më tani në rrethana ende të pashpjeguara”.
31. Gjatë pasditës dhe gjatë lajmeve qëndrore të mbrëmjes në ora 19.30 më 17 mars, raportimi i RTK-së ishte i shënuar me përdorimin e inçizimeve të gjata dramatike, inçizime të pamontuara të protestave të dhunshme dhe viktimave të përgjakura – disa pamje nga afër tregonin gjymtyrë të përgjakura dhe fytyra të shokuara të viktimave dhe anëtarëve të familjeve- pa spjegime të rrëfimit, komente apo kontekste. Dukej se RTK-ja kishte përvetësuar një qasje të “*cinema verite*” të gazetarisë në mes të trazirave civile duke mos marrë parasysh ndikimin emocional të tyre në publik.
32. Në orën 14.35 Komisioneri i Përkohshëm për Media u dërgoi një njoftim urgjent të gjitha subjekteve transmetuese duke i paralajmëruar për obligimet morale dhe profesionale në këso rrethanash që të reduktojnë përmbajtjen

emocionale të emetimeve në atë mënyrë që të informojnë por jo t'i nxisin shikuesit.¹² Në mes të orës 13:00 dhe 14:00 më 17 mars, KPM vizitoi TV 21, KTV-në dhe RTK-në për të përsëritur dhe shtjelluar këtë mesazh personalisht, duke cekur të drejtën dhe obligimet e subjekteve transmetuese për të raportuar lajmet tërësisht, por edhe duke u kërkuar që të bëjnë çdo gjë të mundshme për të “zvogëluar nivelin emocional” të mbulimit të ngjarjeve.

33. KPM-ja në mënyrë të veçantë u ka kërkuar të tri subjekteve transmetuese kryesore që mbulojnë tërë territorin e Kosovës që të ndalojnë transmetimin dramatik “Pa Koment” me filmime të dhunës dhe viktimave, që nuk jepte ndonjë informacion por për nga natyra jepte shkas për shikuesit të reagojnë krejtësisht në mënyrë emocionale. RTK-ja ka bërë një transmetim të tillë pa koment, një filmim shtatë minutësh të paedituar. RTK-ja injoroi kërkesën e KPM-së, duke transmetuar një segment kaotik nga oborri i emergjencës spitalore të paktën katër herë gjatë ditës dhe duke e futur atë në lajmet kryesore të mbrëmjes të orës 19:30.
34. Gjatë vizitës në RTK, KPM-ja ia përkujtoi RTK-së obligimet që të raportojë tërësisht lajmet, por i bëri apel përgjegjësve të lajmeve që të bëjnë çdo gjë të mundshme që të ndikojnë në qetësimin e situatës. Menaxherët thanë se RTK-ja nuk mund të redaktojë dhunën, sepse mund të rrezikohet humbja e besueshmërisë dhe deklaruan se po presnin që udhëheqësit politikë të prononcohen. Duke filluar pak pas orës 14:00, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit z. Nexhat Daci, Kryetari Rugova dhe të tjerët dhanë deklarata. RTK-ja menjëherë i transmetoi këto deklarata dhe vazhdoi t'i ritransmetojë ato në edicionet speciale të lajmeve gjatë pasditës dhe mbrëmjes. Vetë RTK-ja nuk dha ndonjë burim tjetër të kontekstit apo të analizave për ngjarjet e dites.
35. Lajmet kryesore të orës 19:30 të mërkurën, 17 mars, ofruan një mundësi për të theksuar apelet për qetësim dhe rend lidhur me skenat alarmuese të dhunës dhe gjakderdhjes që dominuan në mbulimin e lajmeve të ditës. Megjithatë, përgjegjësit për lajme në RTK, në vend të kësaj, zgjodhën të theksojnë skenat dramatike të dhunës dhe gjakderdhjes të cilat skena gazetarët e tyre i kishin filmuar nga e tërë Kosova. Këto skena nga Mitrovica, Çagllavica dhe nga vende tjera zunë gjysmën e parë të lajmeve para se shikuesit të shihnin udhëheqësit kosovarë dhe ata ndërkombëtarë duke apeluar për qetësi. *Ky ishte një rast i rrallë, nëse jo i vetmi, në të cilin deklaratat zyrtare nga njerëzit siç janë Kryetari dhe Kryeministri, nuk u prezentuan si lajme të para në lajmet e mbrëmjes.*
36. Lajmi që mbylli lajmet e orës 19:30 ishte një tekst që u lexua nga prezantuesi duke cituar një deklaratë të lëshuar më herët gjatë ditës nga drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Gazetarëve Profesionist të Kosovës, Baton Haxhiu. Me këtë

¹² KPM bëri përpjekje përmes e-mailit që të dërgojë një paralajmërim urgjent duke filluar që nga ora 12:30, por problemet në rrjetin kompjuterik e vonuan këtë gjë për mëse dy orë.

u akuzua KPM-ja për përpjekje për të “cenzuruar” lajmet. Ai e akuzoi KPM për tentim cenzurimi të lajmeve dhe “kamuflimit të së vërtetës.”¹³

37. Në mbrëmjen e hershme të 17 marsit, udhëheqësi i misionit të OSBE-së thirri përgjegjësit e tri stacioneve televizive kryesore që mbulojnë tërë territorin e Kosovës për një takim në zyrën e tij, takim që zgjati nga ora 19:15 deri në 19:45, në të cilin mori pjesë edhe KPM. Ambasadori Fieski në mënyrë të hapur ua përkujtoi përgjegjësve mësimin nga Ruanda, në të cilin gazetarët u konsideruan përgjegjës në mënyrë ligjore për nxitje të dhunës, në atë rast për krime lufte. Ai e bëri të qartë se gjithashtu edhe mediat në Kosovë do të konsiderohen përgjegjëse për veprimet e tyre. Takimi tepër vonë ndikoi në lajmet kryesore të RTK-së, por më vonë atë mbrëmje toni nxitës i reportazheve të RTK-së u zbut dhe përdorimi i filmimeve të pa komentuar u ndërpre.

¹³ Z. Haxhiu më vonë i tha KPM-së që ai ekishte lëshuar deklaratën pas marrjes së një ankese nga RTK-ja, por pranoi që paraprakisht nuk kishte verifikuar faktet me KPM-në për këtë çështje. AGPK nuk ka lëshuar ndonjë deklaratë apo koment tjetër për interpretimin e gazetarëve gjatë trazirave.

KONKLuzionet Lidhur Me Radio -Televisionin E Kosovës

1. Një numër i gazetarëve të RTK-së dhe ekipet e kameramanëve treguan guxim dhe qëndrim për t'u lavdëruar gjatë raportimit të bërë nga situatat kaotike të dhunës në tërë Kosovën. Korrespondentët rajonal, duke raportuar në të shumtën e rasteve me telefon u radhitën në llojin nga më të matur dhe të bazuar në fakte e deri te ata emocionalisht të papërshtatshëm. Këta të fundit nuk është dashur të emetohen.
2. Shkathtësia dhe guximi i shumë pjesëtarëve të stafit të lajmeve të RTK-së qëndron në kundërshtim me veprimtarinë e udhëheqësve të RTK-së, vlerësimet e të cilëve për lajme ishin shpesh, nëse jo në kontinuitet, të shënuara me mospërfillje të pamatur për rrezikun e nxitjes dhe acarimit të trazirave qytetare.¹⁴
3. Që nga raportet e para të fragmentuara për mbytjet në ujë të tre fëmijëve që u bënë gjatë lajmeve kryesore të mbrëmjes së 17 marsit, karakteri i mbulimit të lajmit nga RTK-ja duket të ketë qenë i catur nga një dëshirë për një ngjarje dramatike dhe senzacion, dhe ndoshta nga rivaliteti me dy stacionet private, pa një ndjenjë të përgjegjësisë për efektet që transmetimet e tyre mund të kenë pasur në një mjedis jostabil politik. Koncepti i gazetarisë i RTK-së duket të ketë qenë një nga '*cinema verite*', duke e pasqyruar në mënyrë pasive dhunën që kamerat e tyre e kishin zënë, pa një përgjegjësi profesionale për të ofruar kontekst apo komente të arsyeshme derisa udhëheqësit politikë e bënë një gjë të tillë.
4. Storia për mbytjen në ujë të tre fëmijëve, pa marrë parasysh shkakun, ishte padyshim një lajm i madh siç ishte edhe dhuna që pasoi ditën tjetër. Mbulimi i plotë dhe i mbështetur në fakte ishte pa dyshim i domosdoshëm. Gjithashtu kërkohej edhe maturi dhe kontekst shpjegues që do të kishte mundur ta zbuste reagimin – apo ta zvogëlonte rrezikun që mbytjet të përdroreshin para së gjithash si një pretekst i arsyeshëm për shpërthimin e dhunës në Mitrovicë dhe gjetiu.
5. Përgjegjësit për lajme në RTK e panë të udhës t'i besojnë rrëfimit të djalit për incidentin ashtu siç e kishte rrëfyer ai në një intervistë të shkurtër, si të vërtetë dhe të besueshëm, duke anashkaluar qëndrimin e matur të policisë. Kjo ishte një gjë e pamatur dhe joprofesionale.

¹⁴ Përgjegjësit e RTK-së e kanë treguar se ata janë kufizuar nga transmetimi i filmimeve shumë më të përgjakshme dhe shqetësuese të të lënduarve se sa ato që në fakt janë transmetuar, dhe në përgjithësi janë shmangur nga 'vox pop' intervistat me njerëzit në turma, gjë që do të kishte shkaktuar komente nxitëse.

6. Menaxherët e RTK-së thonë se e kanë marrë tregimin e djalit si tërësisht bindës, përderisa policia duke mos konfirmuar e as kundërshtuar atë, kanë lënë të hapur mundësinë që rrëfimi ishte i vërtetë. *Gazetaria e kujdesshme, megjithatë, nuk lejon që të supozohet e vërteta. Gazetaria e kujdesshme kërkonte që të bëhet me dije dyshimi për vërtetësinë.* Duke pasur parasysh njohurinë për rrezikun e një shpërthimi të tensioneve etnike dhe mungesën e ndonjë prove mbështetëse për tregimin e djalit, matura e vërtetë do t'i kishte dhënë përparësi më të madhe, nëse jo në tërësi, qëndrimit të matur (dhe të saktë) të policisë që nuk kishte ndonjë informacion rreth asaj se çfarë në të vërtetë kishte ndodhur. Sikurse që BBC do të thoshte në njoftimet e para, fëmijët u mbytën “në rrethana të pasqaruara”.
7. Disa gazetarë të Kosovës më vonë e kanë fajësuar policinë e UNMIK-ut që kanë dështuar të ofrojnë informata të duhura lidhur me rrethanat e mbytjes së fëmijëve më 16 mars. Sidoqoftë, nga policia nuk mund të pritët të ofrojnë informacione të cilat ajo nuk i ka dhe të cilat nuk është në gjendje t'i sigurojë menjëherë. *Një gabim serioz gazetaresk i të tri subjekteve transmetuese televizive me 16 mars ishte dështimi i tyre që në tërësi dhe qartazi ta vërtetojnë pasigurinë rreth asaj se çka në të vërtetë u kishte ndodhur fëmijëve.* Sikur ta kishin bërë këtë, akuzimet nxitëse në drejtim të “banditëve serbë”- dhe me implikime të të gjithë serbëve të Kosovës- do të kishte tingëlluar më pak bindshëm.
8. Në rend të parë është për të ardhur keq që djaloshi 14 vjeçar, që mbijetoi nga fatkeqësia e Çabrës, nuk ishte të paktën i strehuar përkohësisht nga prindërit, policët apo mjekët ndaj ekspozimit të mediave. Duket që të tri stacionet televizive e kishin lejen e prindërve për intervista që ata bënë me 16 dhe 17 mars, kërkesë e etikës të pranuar përgjithësisht kur fëmijët janë të përfshirë. Sidoqoftë është e pafalshme të dyshojmë se burim i vetëm informacioni në këtë ngjarje- një fëmijë i ri i traumatizuar, i cili mund të ndihej fajtor për humbjen e vëllaut dhe kushërinjëve të tij- të jetë një burim i besueshëm. Matura profesionale kërkon nga gazetarët të dijnë që kujtesa e djalit për ngjarjet mund të mos ishte e saktë apo e plotë, apo që ai nuk ishte në gjendje të tregonte ngjarjen mirë dhe të tërën, apo që kishte mundësi për një shpjegim të pafajshëm të pandërlidhur me etnicitetin, dhe të panjohur për fëmijun se për çfarë arsye ishin ndjekur ata. *Në të vërtetë, në ditën tjetër dhe në intervistën e tretë, në fakt serbët nuk i kishin ndjekur fëmijët. Mbeti çështja e qenit.*
9. Shprehja e shqetësimit të përgjegjësve të RTK-së rreth situatës politike ishte aq e paqëndrueshme sa që ndien obligim ta paralajmërojnë Kryeministrin në mbrëmjen e 16 marsit se standardet plotësisht janë në kundërshtim me materialin që ata kishin zgjedhur të transmetojnë- dy intervista të ndara dhe nxitëse me z. Barani; në reportazhet e korrespondentëve që kthyen tregimin e paqartë të fëmijut të traumatizuar në një mbrojtje të faktit se serbët kishin mbytur fëmijët; zemërimin e hidhur të babait të pikëlluar ndaj serbëve. Njëherësh, RTK-ja ka zvogëluar reportazhet dhe pastaj i ka ndërprerëtë gjitha

ato, si dhe përpjekjet e policisë së UNMIK-ut për të nxitur maturinë dhe theksimin e mungesës së informatave të besueshme rreth asaj se çka në të vërtetë kishte ndodhur.

10. Madje edhe struktura e lajmeve “Blic” në orën 23.15 ka kontribuar panevojë në drejtim të një zhvillimi të hovshëm, të përhapur plotësisht si kërcënim i interesave kombëtare të shqiptarëve- mbytjet në Çabër, protestat e veteranëve të luftës, trazirat në Çagllavicë. Informacioni i njëjtë në mënyrë më të butë mund të ishte emetuar me ndaljen e kësaj sekuence me tregime rutine politike të vendosura në fund të programit.
11. Jo më pak i çuditshëm është vendimi i RTK-së që të ndërpresë transmetimin e reklamave dhe t'i zëvendësojë ato me koncerte simfonike si programe të zakonshme- një lloj flamuri paralajmërues i lajmeve të zymta që normalisht shoqërohen me vdekjen e liderëve apo të ndonjë katastrofe kombëtare- shumë kohë para se katastrofa në të vërtetë të kishte ndodhur dhe para se KTV dhe TV 21 ndryshuan programet e tyre midis lajmeve të jashtëzakonshme rreth rritjes së trazirave.
12. Sa për përdorimin e një pjese të koncertit për Limajn nga RTK-ja nën titrat që raportonin përleshjet e dhunshme, është shumë e vështirë t'i ikësh konkluzionit se kjo ishte një përpjekje e qëllimit për të ngritur emocionet e popullit.
13. Gjatë 16 marsit dhe deri në ditën tjetër, RTK-ja humbi rastin për t'i kontribuar qetësisë, arsyes dhe maturisë rreth stories në Çabër, dhe në vend të kësaj i kontribuoi transformimit të vdekjes së tre fëmijëve në një pikë nxitëse në ripërtërirjen e konfliktit etnik.
14. Shumë nga reportazhet e RTK-së në mbrëmjen e 16 marsit me adresimin e tyre “banditët serb” dhe “hordhitë çetnike” dhe përdorimi i shkujesur i termit “sulm” për të përshkruar se çka u kishte ndodhur fëmijëve- përveç materialit tjetër të emetuar më 17 mars- duket të jetë në konflikt me Kodin Editorial të Sjelljes të vet RTK-së në lidhje me përdorimin e gjuhës “emocionuese” apo “provokative”. Në një pjesë të Kodit të Sjelljes të RTK-së thuhet: “Bëhu i ndjeshëm ndaj efektit të gjuhës. Toni i raportimit duhet të jetë i qetë dhe i matur dhe përdorimi i gjuhës nuk duhet të bëhet në mënyrë emocionale. Është me rëndësi të veçantë që në raportimin e konfliktit të mos përdorim fjalë apo fraza të cilat janë përplotë me emocione.
15. Mbulimi i ngjarjes së Çabrës nga RTK-ja më 16 mars, mund të themi se përmban shkelje të Nenit 2.2 të Kodit të Sjelljes për Mediat Elektronike të KPM-së duke e ndaluar emitimin e materialit me një rrezik të qartë dhe të menjëhershëm për nxitje të dhunës dhe do të trajtohet si i tillë.

16. Me mbulimin e saj të vazhdueshëm të vdekjes së fëmijëve në mëngjesin e datës 17 mars, RTK vazhdoi dështimin e saj për të ofruar kontekst, perspektivë, maturi dhe skepticizëm të arsyeshëm për vdekjet në Çabër. Në të kundërtën, RTK transmetoi komente tjera nga z. Barani në një intervistë të shkurtër të bërë në Çabër atë pasdite.
17. Sapo shpërtheu dhuna në Mitrovicë dhe nëpër Kosovë me 17 mars, mbulimi i RTK-së u shënua me dëshirën e njëjtë për senzacionin e shfaqur në mbrëmjen e një nate më parë, karakteristikë e shprehur shumë qartë me transmetime të përsëritura të pjesëve të gjata të papërpunuara, pamje pa komente të dhunës dhe viktimave të përgjakura që në thelb nuk jipnin asnjë informacion por thjeshtë inkurajonin shikuesit për të reaguar. Udhëheqësit e RTK-së injoruan kërkesën e veçantë të KPM-së në pasditën e hershme të 17 marsit për të ndalur praktikën e cila vazhdoi gjatë lajmeve qendrore të mbrëmjes në 19:30. Në po të njëjtin edicion lajmesh, RTK u bashkua vetë me një deklaratë e cila publikisht kundërshtoi përpjekjet e KPM-së për të zvogëluar emocionet në mbulimin e dhunës në televizion.
18. Efekti emocional i edicionit kryesor të lajmeve më 17 mars u rrit më tepër përmes strukturës së saj, e cila i dha përparësi pamjeve të gjakderdhjes dhe shkatërrimit dhe i shtyu thirrjet e liderëve politikë për qetësi dhe arsye në fund të gjysmës së programit.¹⁵ Sikur të ishin disa nga këto deklarata me thirrje të dyfishta, për qetësim duke hedhur fajin për vdekjen e fëmijëve mbi serbët ose Serbinë.
19. Vendimet e redaksisë së RTK-së, rezistenca e udhëheqësisë për vetëpërbajtje dhe programi që rezultoi më 17 mars përbëjnë shkëlqen e dytë të Nenit 2.2. të Kodit të Sjelljes për Mediat Elektronike të KPM-së dhe do të trajtohet si e tillë.
20. Mungesa e përgjithshme e sqarimit dhe kontekstit në mbulimin e dhunës i ka hequr RTK-së shumicën e kompetencës së mundshme për të stimuluar opinion të arsyeshëm të audiencës. Mungesë e njëjtë është vërejtur në mbulimet e KTV-së dhe TV 21. Kjo reflekton një dobësi të përgjithshme sistematike në lajmet televizive në Kosovë. Lajmet në të tri stacionet televizive me mbulim mbarë kosovar, janë shumë të dominuara nga ngjarjet “protokolare” – paraqitjet zyrtare, mbledhjet dhe konferencat e lajmeve – me një mungesë të dukshme të shpjegimit gazetaresk të çështjeve që ndikojnë në publikun e përgjithshëm. Kontekstet dhe analizat në përgjithësi u janë lënë programeve të diskutimeve në mbrëmje, të cilat vetë nuk japin shpesh debat sqarues. Pamundësia që shpejt të gjinden ekspertët e duhur të cilët do të

¹⁵ Menaxherët e RTK-së sqaruan më 26 mars se ata kanë diskutuar nëse do t'i jipnin përparësi thirrjeve për qetësi, mirëpo vendosën që pamjet e dhunës së vazhdueshme ishin lajme të freskëta, andaj edhe duhej të kishin përparësi. Për dallim, TV 21 ndryshoi radhitjen, duke vendosur deklaratat politike në fillim, me qëllim të theksimit të thirrjeve për qetësi.

jipnin kontekstet dhe shpjegimet – që është një nga vetitë më të fuqishme të subjekteve transmetuese si CNN, BBC-ja dhe subjekteve tjera transmetuese publike evropiane – është vërejtur dukshëm në Kosovë në kohën e krizave.

21. Mbulimi tepër emocional dhe i politizuar i ngjarjeve që shpion nëpër fazat e para të një trazire të madhe civile, në mënyrë të pashmangshme ngriti brengosjen rreth aftësisë dhe angazhimit të RTK që të sigurojë vërtetë një mbulim me lajme të bazuara në fakte, të balancuara dhe gjithëpërfshirëse përderisa Kosova i afrohet zgjedhjeve në tetor.
22. Menaxherët e RTK-së kanë shfaqur një ngurrim shqetësues ose një paaftësi që të kuptojnë se pavarësia e redaksisë nga kontrolli shtetëror – të cilën gjë askush nuk e vë në dyshim – është e lidhur me përgjegjësi të caktuara, posaçërisht në situatat e konflikteve. Këto përgjegjësi përfshijnë minimizimin e përmbajtjeve të emocioneve nxitëse të transmetimit. Rezistenca e udhëheqësisë ndaj këtyre parimeve etike është kryesisht e çuditshme pasi që është shumë qartë e definuar në vetë Kodin e Sjelljes së RTK.
23. Ka të dhëna të qarta që bordi i drejtorëve të RTK-së është i paaftë që të sigurojë një lloj udhëheqje të përbashkët dhe një mbikëqyrje që bordi drejtues i transmetuesit publik duhet të sigurojë. Një faktor kontribues mund të jetë ngurrimi nga ana e udhëheqësisë së RTK-së që të pranojë një mbikëqyrje të atillë nga bordi i saj. Si indikacion i mosfunksionimit të bordit, vetëm katër nga tetë anëtarët e tanishëm kanë ndjekur mbledhjen e rregullt mujore të planifikuar më 24 mars, në një kohë të rëndësishme vendimtare për RTK-në dhe publikun të cilit duhet t'i shërbejë. Kryetari i mëhershëm i bordit, Adem Demaçi, e ka përshkruar bordin të jetë kryesisht “dekorativ”.¹⁶
24. Gjatë gjithë kohës së krizës, radio dhe TV stacionet serbe në Kosovë kur kanë transmetuar lajme janë mbështetur vetëm në stacionet nga Serbia, përfshirë edhe RTS e kontrolluar nga shteti. RTK tani nuk ndodhet askund pranë përmbushjes së kërkesave të parashikuara me status që më së paku 15 % të programit të saj të jipet në gjuhët e pakicave.

¹⁶ Bisedë private me KPM-në

REKOMANDIMET LIDHUR ME RADIO-TELEVIZIONIN E KOSOVËS

- 1. Kthimi i Këshilltarit të Lartë Ndërkombëtar në RTK:** RTK ka nevojë për udhëheqje të mënjëhershme profesionale dhe të qëndrueshme në menaxhimin e lajmeve, posaçërisht përkitazi me mbulimin e situatave konfliktuoze vendore dhe më gjerësisht të paraqesë gazetari të orientuar dhe shpjeguese në mbulimin e lajmeve të tyre. Një këshilltar ndërkombëtar gjithashtu do të shtonte besueshmërinë në mbulimin e paanshëm të zgjedhjeve. Prandaj, ne rekomandojmë kthimin e menjëhershëm të një këshilltari të lartë ndërkombëtar në RTK, të paktën deri në fund të këtij viti. Kjo pozitë kërkon një person me reputacion të padiskutueshëm për intergritetin gazetaresk dhe përvojë me subjektet transmetuese publike në këtë rajon.¹⁶
- 2. Rishikimi i qeverisjes së përbashkët të RTK-së:** Gabimet serioze të vlerësimeve të lajmeve në transmetuesin publik sikur ato të vërejtura në RTK kanë mundësi të jenë simptome të problemeve sistematike të procesit dhe vendim-marrjes në operimin e lajmeve dhe në qeverisjen e përgjithshme. Prandaj, kërkohet rishikimi i qeverisjes së mbrendshme të përbashkët të RTK-së. KPM rekomandon që UNMIK-u duhet të bëjë një rishikim të strukturës, funksioneve dhe anëtarësisë/personelit të Bordit të Drejtorëve dhe Operacioneve Transmetuese që të sigurojë praninë e shkathtësive të nevojshme, eksperiencës dhe temperamentit të domosdoshëm për të siguruar udhëheqje kompetente dhe mbikëqyrje të asaj udhëheqje në RTK. Një rishikim i këtillë duhet të kryhet sipas autoritetit të Rregullorës së UNMIK-ut 2001/13, e cila e themelon RTK. Ky rishikim në asnjë mënyrë s’duhet të dobësojë pavarësinë redaktuese të RTK-së.
- 3. Të pengohet “sakrifica” brenda RTK-së:** Organizatat të cilat kanë dështuar në përgjegjësitë e tyre janë të prirura për të fajësuar individë të nivelit më të ulët më parë se të analizojnë sinqerisht proceset e drejtimit dhe implementimit të standardeve, si Kodi i Etikës i vetë RTK-së. Bordi i drejtorëve dhe bashkësia ndërkombëtare nuk duhet të pranojnë sakrifikimin, largimin nga puna, si zgjidhje adekuate.
- 4. Implementimi aktiv i Kodit të Mirësjelljes së RTK-së:** UNMIK-u dhe bordi i RTK-së, duhet të bëjnë një revizion të procesit me të cilin Kodi i

¹⁶ Kjo nuk duhet të mirret si hap unik ose nënqumës. Pothuaj çdo institucion tjetër në Kosovë tashmë ka këshilltar ndërkombëtar. Ata punojnë nëpër komuna, ministri dhe në Zyrën e Kryeministrit. Nga muaji korrik 2000 deri në dhjetor 2001, ish gazetari i respektuar i BBC-së punoi si drejtor gjeneral i RTK-së dhe pastaj prej atëherë deri në gusht të vitit 2002 punoi si këshilltar i drejtorit të tanishëm gjeneral kosovar. Një këshilltar ndërkombëtar momentalisht është duke punuar në radion dhe televizionin publik të Bosnjës dhe Hercegovinës.

Sjelljes ekzistues i RTK-së i vihet në dispozicion personelit të lajmeve, i shpjegohet dhe zbatimi i tij. Trajnimi praktik për personelin e lajmeve të RTK-së për raportimet gjatë konflikteve duhet të planifikohet dhe të ndërmerret.

- 5. Udhëheqja profesionale menaxhuese për Bordin e RTK-së:** Bordit të drejtorëve të RTK-së, nëse është ose nuk është i ristrukturuar, do t'i nevojitet udhëzim i afërt, profesional nga këshilltarët për menaxhim, të zgjedhur me kujdes përderisa të mësohet të sigurojë një qeverisje të përbashkët efektive. Menaxhmentit të RTK-së gjithashtu i nevojiten udhëzime deri sa të mësojë t'i ofrojë informacione të duhura bordit dhe t'i përgjigjet udhëzimeve të tij.
- 6. RTK-së i kërkohet t'i përmbushë kërkesat e parapara ligjore për shërbimet ndaj pakicave:** Bordi i RTK-së duhet ta ketë detyrë prioritare që të garantojë se RTK e plotëson obligimin e saj sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/13, që t'ia kushtojë më së paku 15% të programit të saj komuniteteve të pakicave. UNMIK-u (duke përfshirë KPM) dhe bordi i RTK-së, duhet të bashkëpunojnë që të sajojnë një plan i cili do të përmbushë këtë qëllim. Cilësisë e jo sasisë së programit duhet t'i jipet rëndësi. RTK-ja duhet të kontribuojë më fuqishëm, jo vetëm të japë programe në gjuhën e pakicave, por edhe programe nëpërmjet të cilave komunitetet e shumicës dhe pakicës komunikojnë me njëra-tjetrën.
- 7. Përkrahja ndërkombëtare për RTK-në:** Duhet të pranohet që RTK-ja është njëri ndër transmetuesit televiziv publik më të rinj në Evropës. Është ende në një fazë të hershme të zhvillimit. Ndërprerja gati e plotë e ndihmës ndërkombëtare në fund të vitit 2003 (përveç ndihmës zvicerane për Radion Blue Sky të RTK-së) duket, në retrospektivë, e parakohshme. Përveç ofrimit të një këshilltari profesionist të mbrendshëm dhe këshillim për menaxhment, komuniteti ndërkombtar duhet të konsideroj vazhdimin e ndihmës së përqëndruar në zhvillimin e mëtutjeshëm të shkathtësive relevante për shërbimet e transmetimit publik, përfshirë koproduksionet. Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Unioni Evropian i Transmetuesve mund të luajnë një rol qëndror ashtu siç bënë në fillim.



KOMISIONERI I PRËKOHSHËM PËR MEDIA
PRIVREMENI KOMESAR ZA MEDIJE
TEMPORARY MEDIA COMMISSIONER

PJESA II

FAKTET DHE REKOMANDIMET LIDHUR ME KTV-NË

PËRMBLEDHJE

1. Mbytja e supozuar në ujë e tre fëmijëve afër fshatit Çabër, e raportuar nga RTK, KTV dhe TV 21 në mbrëmjen e 16 marsit, ishte lajmi kryesor, i cili meritonte mbulim medial të spikatur por edhe të saktë dhe të kujdesshëm, pavarësisht nga rrethanat. Pohimi – si ende i paverifikuar - i një elementi etnik në incident meritonte një trajtim shumë të kujdesshëm, të matur, faktik të stories.
2. Intervistat televizive me një të mbijetuar të traumatizuar 14 vjeçar ngritën çështje serioze etike. Mbase është e vërtetë se sikur djali të mos ishte intervistuar, pohimet për përfshirjen e serbëve nuk do të dilnin në sipërfaqe aq shpejt. Gazetarët e matur, megjithatë, do t'i kishin dhënë së paku peshë të njëjtë deklaratave të policisë se nuk kishte (dhe ende nuk ka) dëshmi të pavarura për të mbështetur këto pohime. Gazetarët e matur do të nënvizonin paqartësinë e asaj çfarë faktikisht u kishte ndodhur katër djemve. Gazetarët e matur do të kishin kërkuar të nxjerrin detaje sqaruese nga djali.
3. Njoftimeve të para të të tri stacioneve televizive, që mbulojnë tërë teritorin kosovar, për zhdukjen e tre fëmijëve në shkallë të ndryshme u mungon kjo maturi elementare. Bashkërisht këto subjekte transmetuese i kontribuan një përshtypjeje – atëherë apo më vonë e vërtetuar—se serbët i kishin ndjekur tre fëmijët dhe se ishin shkaktarë të mbytjes së tyre në ujë. Kjo përshtypje dha një shkëndi apo pretekst për demonstratat dhe dhunën që shpërtheu më 17 mars.
4. Kishte një dallim cilësor në mes të mbulimit të lajmeve për ngjarjet e 16-17 marsit nga RTK dhe të atyre nga KTV. KTV nuk bëri asgjë për ta politizuar tregimin apo që ta vënte atë në një përmbajtje emocionale, patriotike që në mënyrë të pakujdesshme rrezikonte të nxiste dhunë në publik dhe të acaronte situatën, siç kishte bërë RTK.
5. Sikurse me stacionet tjera televizive, disa korrespondentë të KTV-së treguan qëndrim dhe guxim gjatë raportimit nga skenat kaotike të dhunës dhe gjakderdhjes. Të tjerë, sidoqoftë—veçanërisht në Gjilan dhe Gjakovë—regjistruan raporte tepër të njëanshme që nuk ishin të kundërshtuara apo të përmirësuara.
6. KTV-ja ka dështuar të ofrojë kasetat e arkivit të shumicës së programit të saj. Kjo përbën shkelje të kushteve të licencës së saj dhe do të trajtohet si e tillë.

FAKTET LIDHUR ME KTV-NË

1. Sipas menaxherëve të KTV-së, stacioni televiziv për herë të parë mësoi për një ngjarje, që përfshinte vdekjen e mundshme të tre fëmijëve, nga një burim i paidentifikuar nga Mitrovica rreth orës 19.30 më 16 mars. Një thirrje telefonike për korrespondentin e KTV-së në Mitrovicë dha informacionin se një shpërthim sapo kishte ndodhur në Mitrovicë por nuk kishte viktimë.
2. Njoftimi i parë i KTV-së për incidentin ishte lajmi i parë në orarin e rregulltë të programit të lajmeve të vona të orës 22.30, përmes një raporti telefonik nga korrespondenti nga Mitrovica. KTV nuk ka qenë në gjendje të ofrojë audio inçizimin e këtij raporti. Prandaj KPM nuk di për përmbajtjen e tij.
3. Pas raportit të korrespondentit pasoi intervista e KTV-së me djaloshin e mbijetuar, Fitim Veseli. Në këtë intervistë, që duket se është bërë përafërsisht dy orë pasi që djaloshi kishte biseduar me RTK-në, ai e bën të qartë se ai dhe shoqëruesit ikën prej një qeni, jo prej serbëve. Pjesërisht ai thotë: “ishim duke shëtitur matanë lumit dhe kur disa serbë, d.m.th. dy serbë deshtën të na sulmojnë, por sa për ata ne kishim shpëtuar por kishin edhe një qen. Se ne kishim frikë prej atij, se prej shkiqeve jo, se ju kishim shpëtuar atyre se ishin shumë larg por qeni vrapojke shpejt dhe ne ishim afër lumit”. **[Shih transkriptin 8]**
4. Intervistuesi dështoi të bënte pyetje të cilat ndoshta do ta kishin bërë të qartë pse fëmiu mendoi se njerëzit të cilët ai i pa deshën t’i “sulmonin” ata. Ditën tjetër ai i tha TV 21 që dy serbët i kishin sharë nga shëpia që ishte pak më larg. Është e panjohur nëse ai ose fëmijët tjerë kishin kuptuar se çka serbët pretenduan të thonë. Sidoqoftë ai pohoi se qeni i kishte ndjekur fëmijët.
5. Rreth orës 01.00 më 17 mars, KTV ritransmetoi pamje të përpjekjeve të policisë, TMK-së dhe KFOR-it për gjetjen e trupave të fëmijëve të zhdukur, së bashku me intervistën e përsëritur me djaloshin e mbijetuar. Ky raport nuk ishte i përcjellur me tregimin nga studio e Prishtinës, dhe asnjë korrespondent nuk paraqitej në inçizim. KTV ofroi një kopje të këtij raporti.
6. Raporti i orës 01.00 përfshiu intervistën e shkurtër me zëdhënësen e policisë së UNMIK-ut, Tracy Becker, që zgjati për 22 sekonda, ose afërsisht dy herë më gjatë se ekstrakti i inçizimit të RTK-së me znj. Becker. Ajo është cituar të ketë thënë (në ripërkthim nga gj.shqipe në angleze): “Krejt çka dijmë për momentin është se janë zhdukur tre fëmijë. Kemi marrë informacione se në lumin Ibër kanë rënë katër fëmijë, mirëpo fatmirësisht njëri nga ata ka shpëtuar dhe gjendet në shtëpinë e tij. Moshë e këtyre fëmijëve e dijmë se është 9 deri 12 vjeç. Ne edhe më tutje jemi në kërkim të trupave të tjerë dhe se motivi i këtij incidenti nuk është i njohur”.

7. Në Mitrovicë, derisa mediat u mblodhën të raportojnë lidhur me kërkimin e fëmijëve të zhdukur gjatë mbrëmjes së 16 marsit, policia e UNMIK-ut tha se vazhdimisht u kishte sqaruar gazetarëve të RTK-së dhe atyre të mediave tjera që asnjë informacion nuk është i gatshëm ta konfirmojë ose ta mbështes ngjarjen e treguar nga djaloshi i mbijetuar se fshatarët serbë dhe qentë ishin përfshirë në njëfarë mënyre në këtë ngjarje. Zëdhënësja e policisë Becker tha: “Kam biseduar me RTK-në dhe KTV-në jo më pak se tri herë. U thashë, ‘Mos jepni përfundime. Nëse është e vërtetë ne do t’ju tregojmë.’” Ajo shtoi: “unë mora thirrje nga Associated Press prej Reuters dhe të tjerët. U thash të gjithëve të njëjtat gjëra: Ne nuk mund të konfirmojmë këtë storie.”¹⁷
8. Zëdhënësi i UNMIK-ut Gyorgy Kakuk, tha se gazetarët thjeshtë nuk dëgjonin apelet paralajmëruese të ndërkombëtarëve në vendin e ngjarjes: “Ne e parandjenim atë mbrëmje se kjo ishte e kotë, dhe se mesazhi nuk do të depërtonte.”
9. Ngjajshëm me inçizimet e shkurtëra të përdorura nga RTK, edhe në KTV pjesa që citon Zonjën Becker nuk përmban thirrjet e theksuara për maturi rreth asaj se çfarë në të vërtetë u kishte ndodhur fëmijëve, gjë që ajo tha se u kishte kërkuar të raportojnë.
10. Znj. Becker siguroi një hapësirë për gazetarët, ku ata mund të filmonin dhe merrnin informata të shkurtra, dhe t’u shmangeshin ndërhyrjeve me ekipet e kërkimit përgjatë brigjeve të lumit. Ajo dhe përfaqësuesit e tjerë të UNMIK-ut thanë se korrespondentët e të dy televizioneve, RTK-së dhe KTV-së, nuk bashkëpunonin, duke ratisur në vendin e kërkimit edhe përkundër instruksioneve, por që “KTV-ja nuk ishte edhe aq jo bashkëpunues; RTK ka qenë më i keqi.”
11. Televizioni i KTV-së ndërpreu transmetimin sipas orarit rreth orës 01.50 më 17 mars pa lajme të mëtejshme. Sikur TV 21, dhe në kundërshtim me RTK-në, KTV-ja nuk emtoi intervistat në raportet fillestare të saj të 16 apo të 17 marsit që kishin efekt në politizimin e stories së vdekjes së fëmijëve apo dhënies rëndësi patriotike incidentit. Sikur TV 21, dhe ndryshe nga RTK-ja, KTV i është përmbajtur orarit të rregullt programor dhe reklamave gjatë mbrëmjes së 16 marsit dhe gjysmës së parë të 17 marsit, derisa dhuna shpërtheu në Mitrovicë dhe pastaj edhe në lokacionet tjera. KTV-ja, si TV 21, trajtoi storien e mbytjes në ujë si një lajm normal, edhe pse tragjik.
12. Si stacionet tjera, KTV pati vështirësi të qëndronte me një storie krejtësisht ndryshe që filloi me dhunën që shpërtheu vonë në mëngjes në Mitrovicë më 17 mars dhe që u përhap në shumë vende tjera nëpër Kosovë. Të tri stacionet, në shkallë të ndryshme, u mbështetën në raportet telefonike të

¹⁷ Intervista e KPM-së më 26 mars në Mitrovicë me përfaqësuesin për media të policisë së UNMIK-ut Barry Pollin , Tracy Becker dhe zëdhënësin e UNMIK-ut Gyorgy Kakuk.

korrespondentëve. Disa nga këta ishin të qetë dhe të bazuar në fakte gjersa të tjerë ishin shumë të emocionuar dhe me paragjykime të karakterit anti-serb.

13. Një korrespondent i KTV raportoi nga Gjakova: “Aktet kriminale të popullatës serbe të veriut gjatë demonstratave paqësore janë dënuar nga popullata e Gjakovës. Kërkohej fundi i këtyre akteve terroriste ndaj popullatës shqiptare. Duke shprehur solidaritet protestuesit marshuan drejt rrugës serbe dhe kishës serbe iu kishte vënë zjarri. Situata është e qetë, ndërsa kisha është duke u djegur.”¹⁸
14. Ngjajshëm, korrespondenti i KTV nga Gjilani raportoi: “Tridhjetë të plagosur dhe një i vdekur është bilanci i ngjarjeve të sotme. i vdekuri është një serb, i cili sipas dëshmitarëve doli nga shtëpia e tij me kallashnikov dhe provokoi protestuesit, pastaj ata ia morrën armën, më pas serbi vdiq nga plagët e marra.”¹⁹
15. Gjatë 17 marsit, gjatë ditës, mbulimi i KTV-së, sikurse ai i RTK-së, përfshinte disa pjesë të gjata (me minutazh të gjatë) të inçizimeve pa folës apo komente që tregonin skenat e dhunës dhe pavionet kaotike të spitalit me viktime të përgjakura. Disa nga këto pjesë ishin të emërtuara në ekran, “Pa Koment.” Pasi që nuk përmbanin asnjë informacion, këto pjesë mund të kishin ftuar shikuesit që të reagojnë më tepër emocionalisht sesa në mënyrë të arsyeshme.
16. Një pjesë e tillë “Pa Koment” u shfaq në programin e lajmeve kryesore të mbrëmjes që përfundoi në orën 19.50 më 17 mars, pesë orë më vonë pasi që KPM-ja në mënyrë të veçantë kishte kërkuar nga KTV-ja (dhe stacionet tjera me mbulim mbarë kosovar) që të mos emetojnë inçizime të tilla pa informata përcjellse.
17. Përdorimi i inçizimeve të pakomentuara nga KTV-ja, megjithatë, ka qenë më pak i përdorur sesa ato në RTK, dhe nuk ka qenë i prezentuar në konteksin e llojit politik dhe patriotik që RTK-ja kishte ndërtuar rreth stories së vdekjeve të fëmijëve, gjatë periudhës disa orëshe.
18. Gjatë pasditës së 17 marsit, KTV kërkoi informacione dhe situatën nga zëdhënësi i SHPK-së Refki Morina.
19. Sikur RTK, KTV dhe TV 21 përmbanin deklaratat e udhëheqësve politik që bënë apele për qetësi (në të shumtën e rasteve të lidhura me sulme ndaj

¹⁸ Transkriptet e cituara të korrespondentëve të KTV-së të marra nga kasetat e inçizuara nga KPM.

¹⁹ Sipas raportit të OSBE-së, duke cituar në zyrar të lartë lokalë në Gjilan, viktime kishte armë por nuk shkrepri me të. Pasi që u çarmatos, viktime ishte “goditur dhe rrahur për vdekje për më se gjysmë ore nga dhjetra të rinjë shqiptar, të brohoritur nga turma. Ajo çka kishte ndodhur në realitet ishte vrasje pa gjyq nga turma, të cilën mediat e prezentuan si një “vdekje klinikisht të pastër dhe të papritur.”

“kriminelëve serb” të cilët supozoheshin se ishin përgjegjës për vdekjen e fëmijëve). Sidoqoftë, KTV-ja filloi të transmetojë deklarata të tilla të Presidentit Rugova dhe të tjerëve, për afërsisht prej orës 14.50 më 17 mars, apo një orë më vonë dhe më shkurtimisht sesa RTK-ja.

20. Rradhitja e lajmeve në programin kryesor të lajmeve të mbrëmjes që filloi në orën 19.00 më 17 mars filloi me apelin e Kryeministrit Rexhepi për qetësi, dhe pastaj kaloi në mes të raporteve të dhunës së ditës dhe thirrjeve për qetësi. Kjo ishte një strukturë emocionalisht neutrale, duke mos theksuar as ngjarjet dramatike në rrugë e as reagimet politike.
21. Vonë atë mbrëmje KTV shfaqti një intervistë të gjatë me Veton Surroin, e cila përbënte element madhor të analizës racionale në mbulimin e lajmeve të ditës.

KONKLuzionet Lidhur Me KTV-NË

1. Raportimi i KTV-së për mbytjen e mundshme në ujë të tre fëmijëve më 16 mars dha një besim të pajustificuar në storien e djaloshit të mbijetuar. Duke vepruar kështu KTV-ja dështoi në prezentimin e një paqartësie në lidhje me atë se çfarë kishte ndodhur, siç kërkonte policia nga ta. Efekti i rrjetit televiziv ishte që të kontribuonte në përshtypjen e përgjithshme, të pambështetur nga fakti i verifikueshëm, se serbët i kishin shtyrë fëmijët të gjenin vdekjen në lum.
2. Intervista e KTV-së me djaloshin e mbijetuar tregoi se fëmijët, sipas të mbijetuarit, kanë ikur nga qeni por jo nga njerëzit. Por KTV-ja nuk bëri asgjë për të tërhequr vëmendjen në këtë zbulim të rëndësishëm, i cili duket të jetë zmadhuar pa vënë re në këtë stuhi zemërimi që u zhvillua rreth vdekjeve të fëmijëve. Kështuqë, KTV-ja humbi një mundësi të rëndësishme që të ndryshojë perceptimin publik të ngjarjes para se dhuna të shpërthente ditën e ardhshme.
3. Si me stacionet tjera, disa korrespondentë të KTV-së shfaqën një qëndrim dhe një guxim gjatë raportimit nga skenat kaotike të dhunës dhe gjakderdhjes. Sidoqoftë, disa korrespondentë të KTV-së – sidomos në Gjiilan dhe Gjakovë- regjistruan raportet tepër të njëanshme që nuk ishin as të kundërshtuara dhe as të përmirësuar.
4. Dështimi i KTV-së për sjelljen e video-kasetave nga arkiva, të shumicës së programit të saj, përbën shkelje të kushteve të licencës së saj dhe do të trajtohet si e tillë.
5. KTV-ja shfaqti një preferencë më të fortë për ngjarjet dramatike dhe senzacionet në raportimin e saj të dhunës se sa TV 21. Por nuk bëri asgjë që të politizojë vdekjet e tre fëmijëve apo të krijojë një lloj histerie patriotike rreth stories që veçonte mbulimet e RTK-së

REKOMANDIME LIDHUR ME KTV

- 1. Trajnimet dhe diskutimet e raportimit në konflikt:** Si shumica e mediave në Kosovë, KTV do të përfitonte nga trajnimet specifike për korrespondentë dhe redaktorë në etikën dhe teknikat e raportimit të konflikteve. Rëndësia e kërkimit, dhe prezentimit të tërësishëm, të këndvështrimit të policisë në ndonjë incident përfshirë këtu vdekjen apo lëndimin – posaçërisht kur faktorët etnik mund të jenë të përfshirë, nuk mund të jenë të stërtheksuar.
- 2. Rishikimi i korrespondentëve lokalë:** KTV-ja duhet që tërësisht dhe menjëherë të shqyrtojë kualifikimet e korrespondentëve lokalë dhe t'i largoj ata të cilët nuk janë në gjendje apo nuk dëshirojnë t'u përmbahen standardeve elementare etike të drejtësisë, barazisë dhe lirisë nga njëanshmëria etno-kulturore apo politike.
- 3. Mirëmbajtja e arkivës transmetuese:** KPM-ja do ta ngarkojë me sanksione dështimin e KTV-së në ruajtjen për 21 ditë të arkivës së programeve të saj të transmetuara. KTV-ja do të jetë mirë e këshilluar për ta implementuar këtë sistem brenda 30 ditëve të ardhshme më së largu.

PJESA III

FAKTET DHE REKOMANDIMET LIDHUR ME RTV 21

PËRMBLEDHJE

1. Mbytja e supozuar e tre fëmijëve afër fshatit Çabër, e raportuar nga RTK, KTV dhe TV 21 në mbrëmjen e 16 marsit, ishte lajmi kryesor, i cili meritonte mbulim medial të spikatur por të saktë dhe të kujdesshëm pavarësisht nga rrethanat. Deklatata – si ende e paverifikuar - i një elementi etnik në incident meritonte një trajtim shumë të kujdesshëm, faktik, të matur të stories.
2. Intervistat televizive me një të mbijetuar të traumatizuar 14 vjeçar ngritën çështje serioze etike. Mbase është e vërtetë se sikur djali të mos ishte intervistuar, pohimet për përfshirjen e serbëve nuk do të dilnin në sipërfaqe shpejt. Gazetarët e matur megjithatë, do t'i kishin dhënë së paku peshë të njëjtë deklaratave të policisë se nuk kishte (dhe ende nuk ka) dëshmi të pavarura për të mbështetur këto pohime. Gazetarët e matur do të nënvizonin paqartësinë e asaj çfarë faktikisht kishte ndodhur me katër djemtë. Gazetarët e matur do të kishin kërkuar të nxjerrin detaje sqaruese nga djali.
3. Në raportimet e para për zhdukjen e tre fëmijëve, të tri stacioneve televizive me mbulim mbarë kosovar, në shkallë të ndryshme u mungonte kjo maturi elementare. Në raportimin e parë të 16 marsit, TV 21 dështoi ta përfshinte një mesazh urgjent që policia përpiqej ta përcjellte, se nuk kishte prova të pavarura për ta përkrahur tregimin e djalit. Bashkërisht këto subjekte transmetuese i kontribuan një përshtypjeje—as atëherë apo më vonë e vërtetuar—se serbët i kishin ndjekur tre fëmijët dhe se ishin shkaktarë të mbytjes së tyre në ujë. Kjo përshtypje dha një shkëndi apo pretekst për demonstratat dhe dhunën që shpërtheu më 17 mars.
4. Kishte një dallim cilësor në mes të mbulimit të lajmeve për ngjarjet e 16-17 marsit nga RTK dhe të atyre të TV 21. TV 21 nuk bëri asgjë për ta senzacionalizuar apo politizuar tregimin apo ta vënë atë në një përmbajtje emocionale, patriotike që në mënyrë të pakujdesshme rrezikonte të ndezte dhunë në publik dhe të acaronte situatën, siç kishte bërë RTK. TV 21 në veçanti qartë provoi me mbulimin e saj të 17 marsit të ul apo zvoglojë karakterin emocional të raportimit të tij gjersa në të njëjtën kohë duke informuar plotësisht shikuesit e tij rreth ngjarjeve të ndërlikuara dhe alarmuese.

FAKTET LIDHUR ME TV 21

1. TV 21 në fillim raportoi zhdukjen dhe mbytjen e mundshme në ujë të tre fëmijëve në orarin e rregullt të lajmeve të reja të orës 22:00 më 16 mars, apo për afërsisht dy orë e gjysmë pas raportit të parë të RTK-së. Incidenti në Çabër ishte historia e parë. Sidoqoftë, TV 21 nuk kishte dërguar një ekip xhirimi në vendin e ngjarjes deri të nesërmen.
2. Prezentuesi paraqiti lajmin duke pohuar kategorikisht se, “Dy serbë ndoqën katër fëmijë shqiptarë sot rreth orës 16:00 në fshatin Çabër, dhe gjersa u munduan t’u ikin atyre, kërcyen në lum”. Nuk kishte atributim për burimin dhe as bazë faktike për këtë pohim.
3. Pasi një raport telefonik nga një korrespondente e TV 21-shit në Mitrovicë, Mirlinda Jashari. Ajo tha: “Siç rrëfeu fëmiu 13 vjeçar Fitim Çerkin Veseli nga ky fshat, në këtë kohë ai dhe 5 moshatarë të tij kishin qenë duke shëtitur matanë lumit Ibër. Në atë çast nga një shtëpi serbe kanë dalur dy persona të cilët kishin me vete një qen dhe kanë filluar t’i ndjekin fëmijët. Nga frika katër nga fëmijët kanë kërcyer në lumin Ibër me shpresë se duke notuar do ta kalojnë atë. Mirëpo, meqë uji kishte qenë i rrëmbyeshëm lumin arrin ta kalojë vetëm Fitim Veseli ...”
4. Korrespondentja në fakt nuk pohoi të kishte biseduar me fëmiun dhe nuk e identifikoi burimin e informacioneve të saja. Ajo mund të ketë përmbledhur informacione nga reporterët tjerë nga vendi i ngjarjes, një praktikë e rrezikshme por e zakonshme e përdorur në mesin e gazetarëve që mbulojnë historitë e lajmeve të jashtëzakonshme. Megjithatë, asnjë gazetar i matur nuk mbështetet krejtësisht në kolegët që të raportojë një histori të tillë, veçanërisht në ato me implikacione shpërthyes.
5. Në të tri intervistat e ndara për televizionet, atë me RTK, KTV dhe TV 21 ditën tjetër, djaloshi i mbijetuar nuk ka thënë qartë që serbët- ose njerëzit që “dolën nga shtëpia serbe”, siç ka thënë korrespondenti i TV 21 - faktikisht që i kanë ndjekur fëmijët. Në të vërtetë, djaloshi qartë theksoi në KTV dhe më vonë në TV 21 se ata ikën të frikësuar jo prej njerëzve por prej qenit. Kështu që nuk ka pasur dhe ende nuk ka baza faktike për raportin fillestar të TV 21 që serbët ndoqën fëmijët dhe shkaktuan mbytjen në ujë të tre fëmijëve.
6. Raporti i TV 21 nuk përmban ndonjë referencë çoftë nga policët e UNMIK-ut, të cilët menjëherë u thanë reporterëve në vendin e ngjarjes afër Mitrovicës se nuk kishte informata të pavarura për mbështetjen e stories së djaloshit. Duke dështuar ta citojnë në përgjithësi, madje edhe në mënyrë sipërfaqësore të parë në RTK dhe KTV, TV 21 dështoi tërësisht të njoftojë shikuesit e tij për elementin vendimtar të paqartësisë në këtë histori.

7. Në Mitrovicë, derisa mediat u mbledhën për të mbuluar kërkimin e fëmijëve të humbur gjatë mbrëmjes së 16 marsit, policia e UNMIK-ut vazhdimisht u kishte sqaruar gazetarëve të RTK-së dhe atyre të mediave të tjera që nuk ka asnjë informacion të konfirmojë ose të mbështes storien e treguar nga djaloshi i mbijetuar, se fshatarët serbë dhe qentë ishin përfshirë në njëfarë mënyre në incident. Zëdhënësja e policies, Becker, tha: “Kam biseduar me RTK dhe KTV jo më pak se tri herë. U thashë, “Mos bëni përfundime. Nëse është e vërtetë ne do t’ju tregojmë”. Ajo shtoi: “Unë mora thirrje nga Associated Press prej Reuters dhe të tjerët. U thash të gjithëve të njëjtat gjëra: Ne nuk mund ta konfirmojmë këtë storie.”
8. Zëdhënësi i UNMIK-ut Gyorgy Kakuk tha që gazetarët thjeshtë nuk dëgjonin apelet paralajmëruese të ndërkombëtarëve në vendin e ngjarjes: “Ne e parandjenim atë mbrëmje se kjo ishte e kotë, dhe se mesazhi nuk do të depërtonte.”
9. Korrespondenti i TV 21 gjithashtu raportoi që një shpërthim i fortë ka shqetësuar banorët e kompleksit të Tri rrokaqiejve në Mitrovicë, menjëherë pas orës 19.00, por që “ende nuk dihet kush qëndron pas këtij shpërthimi”. Në këtë rast, korrespondenti raportoi një fakt të rëndësishëm të paqartësisë.
10. Raporti i TV 21 për ngjarjen e Çabrës më 16 mars ishte i kufizuar me këtë raport telefonik, edhe pse ishte i përsëritur gjatë mbrëmjes në orar të rregullt të lajmeve të reja në çdo orë. Në dallim prej RTK, TV21 nuk pohoi që turma të mëdha njerëzish lëviznin në drejtim të Çabrës. As raportet e lajmeve të TV 21 nuk bënë spekulime se si mund të reagoonte publiku ndaj vdekjeve, e madje as të raportoj për shtimin e “revoltës”, siç pohoi korrespondenti i RTK-së.
11. Përmbajtja patriotike/politike dhe emocionale ndezëse që RTK-ja në mënyrë sistematike e sajoi rreth stories gjatë mbrëmjes së 16 marsit dhe në ditën e ardhshme të 17 marsit, mungonte në raportet e TV 21. Asnjëherë TV21 nuk e intervistoi Halit Baranin, anëtarët e pikëlluar të familjeve të fëmijëve të zhdukur apo ndonjë individ tjetër, që orvateshin të nxjerrin përfundime të vrullshme politike rreth incidentit, siç kishte bërë RTK-ja.
12. Si KTV dhe ndryshëm nga RTK-ja, TV 21 i është përmbajtur orarit të rregullt programor dhe reklamimeve gjatë mbrëmjes së 16 marsit dhe gjysmës së parë të 17 marsit, derisa dhuna shpërtheu në Mitrovicë dhe së shpejti edhe në lokacionet tjera. Shkurtimisht, TV 21, sikurse dhe KTV, trajtuan vdekjet e tre fëmijëve si një lajm normal edhe pse tragjik, dhe jo si një moment të të shënuar e të rëndësishëm politik apo patriotik.
13. TV 21, në lajmet më të reja të mbrëmjes së 16 marsit, raportoi për protestat në vijim e sipër në Çagllavicë, ku serbët lokal, duke e bllokuar rrugën kryesore protestonin kundër plagosjes të një riu serb. Raportimi i TV21 për këtë ngjarje ishte shumë më real se ai i RTK-së. TV21 zhvilloi intervista të

detajizuara me zëdhënësit e policisë së UNMIK-ut dhe të SHPK-së gjithashtu emetoi edhe deklaratat e udhëheqësve politik duke e dënuar sulmin. RTK ua ka kushtuar vetëm një fjali këtyre dënimeve në storien prej 33 sekondash në edicionin e lajmeve Blic në orën 23:00. TV21 në raportin 7 minutash e 49 sekonda kushtuar Çagllavicës, gjysmën e kësaj kohe ia ka kushtuar këtyre deklaratave të rëndësishme.

14. Ngjajshëm, TV21 raportoi edhe për protestën e veteranëve të UÇK-së, të zhvilluar në tërë Kosovën, kundër arrestimeve të disa anëtarëve të tyre. Ndërsa RTK theksonte pamje me përmbajtje emocionale në raport prej 39 sekondash në edicionin e Blicit, TV21 ia kushtoi 2 minuta e 11 sekonda stories së njëjtë. Sidoqoftë, storia tërësisht është bazuar në pikëpamjet e veteranëve duke mos përfshirë pikëpamjet e policisë së UNMIK-ut apo autoriteteve tjera.
15. Gjersa dhuna shpërtheu në Mitrovicë në mëngjesin e 17 marsit, TV21, i kufizuar në paisje teknike ishte i ngadalshëm të ofronte inçizimet e përleshjeve të para në Mitrovicë. Raporti i parë telefonik është përcjellur me inçizime nga arkivi me pamje nga Mitrovica e qetë, gjatë verës. Rezultati ishte, që së paku fillimisht, TV21 ofroi informata të detajizuara me përmbajtje minimale alarmuese apo pamje emotive.
16. Në raportimet e tyre për përleshjet e dhunshme dhe për arritjen e të plagosurve në spitale, TV21 ashtu si KTV dhe RTK, i futi në shfrytëzim inçizimet dramatike të papunuara, të paredaktuara, dhe të pakomentuara për të përshkruar pamjet kaotike, posaçërisht të njerëzve të plagosur. Megjithatë, përdorimi i inçizimeve të atilla të pakomentuara nga ana e TV21 të cilat bartin pak informata por i thërret shikuesit të reagojnë emocionalisht- ishte më pak i theksuar se sa ai i RTK, dhe nuk ishte prezentuar me përmbajtje të njëjtë të indinjatës politike dhe patriotike që RTK ka sajuar rreth stories.
17. Përdorimi i inçizimeve të pakomentuara nga ana e TV21 duket se ishte ndalur pasi që KPM i vizitoi udhëheqësit e stacionit herët pasdite për të reafirmuar të drejtat dhe obligimet e tyre për raportimin e plotë të ngjarjeve por duke kërkuar nga ata që të bëjnë çmos për ta ulur “temperaturën emocionale” të mbulimit të tyre.
18. Ashtu si RTK dhe KTV, TV21 transmetoi deklaratat e udhëheqësve politik duke apeluar për gjakftohtësi (në të shumtën e rasteve duke i lidhur ato me sulmet e “kriminelëve serbë” të cilët supozohen të kenë qenë përgjegjës për vdekjen e fëmijëve). TV21 filloi transmetimin e deklaratave të Kryetarit Rugova dhe të tjerëve rreth orës 14:50 më 17 mars, ose gati një orë pas RTK.
19. Në pasditën e vonshme të 17 marsit, TV21 kërkonte qartazi mendimin analitik të Ramush Tahiraj, Këshilltar i lartë i Kryetarit të Parlamentit, Nexhat Daci.

20. Struktura e lajmeve kryesore të mbrëmjes të TV21 në orën 18:30 më 17 mars, dallohej dukshëm prej atyre të RTK-së. Ndërsa RTK theksonte pamjet emocionale të dhunës kaotike në gjysmën e parë të lajmeve kryesore atë mbrëmje para përsëritjës së thirrjeve për gjakftohtësi të udhëheqësve politikë dhe të komunitetit ndërkombëtar, TV21 ndryshoi renditjen e lajmeve të tyre, duke theksuar thirrjet- edhe pse ato ishin emetuar gjatë pasditës. Udhëheqësit e TV21 thanë se vepruan ashtu me qëllim që t'i inkurajojnë shikuesit të reagojnë racionalisht më parë se emocionalisht ndaj ngjarjeve të ditës.
21. TV21, jo si RTK dhe KTV, bënë përpjekje transparente për të përcaktuar se çfarë në të vërtetë u ka ndodhur tre djelmohave më 16 mars, duke e marrë në intervistë tek vendi i ngjarjës në ditën e nesërme djaloshin e mbijetuar. Djaloshi bënte me gisht në drejtim të shtëpisë në distancë- që dukej së paku 100 metra larg nga bregu i lumit- dhe shpjegonte se dikush kishte bërë titur nga shtëpia, dhe se ishte qeni nga i cili ata ikën me frikë. Kjo intervistë ishte veprimi i vetëm i raportimit shpjegues që KPM e ka vërejtur më 17 mars. Fatkeqësisht, ajo është emetuar shumë vonë (në lajmet e mbrëmjes në orën 18:30) që të mund të kishte ndikim në perceptimin e shikuesve për incidentin i cili ndezi, ose shërbeu si pretekst për dhunë.

KONKLuzionet Lidhur Me TV 21

1. Raporti fillestar i lajmeve për incidentin në Çabër nga TV21 në ora 22:00 të 16 marsit bashkangjiti besimin e pajustificuar të stories së djaloshit të mbijetuar, dhe nuk u prezantua saktësisht se çfarë u ka thënë ai intervistuesve. Ky raport, të cilin TV 21 e përsëriti gjatë mbrëmjes, gjithashtu dështoi ta përfshijë këndvështrimin qenësor që policia i kishte udhëzuar reporterët t'i përmendin, e cila ishte se nuk kishte dëshmi të pavarura për të mbështetur storien e djaloshit.
2. Kështuqë, TV 21 dështoi në përdorimin e informatave nga policia – ku nuk kishte informata solide, vetëm në mënyrë të paqartë se çfarë shkaktoi mbytjen e fëmijëve – e cila ishte lehtë e mundur për t'u bërë për korrespondentin e TV 21 në Mitrovicë. Përgjegjësit e lajmeve do të duhej të vërenin se këndvështrimet e policisë mungonin nga raporti i tyre
3. Ky dështim mund të interpretohet si shkelje e Nenit 7.2 të Kodit të Sjelljes për Media Elektronike të KPM-së i cili thekson se, “Emetuesit nuk do të mund transmetojnë material derisa nuk e bëjnë kërkimin rutinor dhe të arsyeshëm për të siguruar saktësinë e tij”.
4. Derisa dhuna zhvillohej më 17 mars, TV 21 – sikurse edhe dy televizionet tjera – u përpoq të përcjellë përhapjen e shpejtë të tregimit kaotik dhe frikësues. Korrespondentët e tyre shfaqën një qëndrim dhe guxim gjatë raportimit nga vendi i ngjarjes në përleshjet me policinë dhe KFOR-in dhe nga djegjet e shtëpive dhe kishave.
5. Prezantuesit e TV 21 iu qasën tregimit në mënyrë të qetë dhe bënë një përpjekje të lëvdëruar për përfshirjen e komenteve dhe analizave të arsyeshme ashtu si u zhvilluan ngjarjet më 17 mars.
6. Ndryshe nga RTK-ja, TV 21 trajtoi vdekjen e tre fëmijëve si normale (edhe pse ishte tragjike), si një lajm. TV 21 nuk bëri asgjë për ta politizuar storien apo nuk senzacionoi raportin e tyre të 16 marsit dhe gjatë 17 marsit dhe nuk i bashkangjiti asgjë me domethënie “patriotike” vdekjes së vogëlushave apo dhunës që pasoi.
7. Në të kundërtën, TV 21 mori hapa që janë për t'u lavdëruar që të mësojnë se çfarë në të vërtetë u kishte ndodhur katër djelmohave, me intervistën e tyre që bënë me të mbijetuarin në vendin e ngjarjes së incidentit. TV 21 raportoi për dhunën në një mënyrë të qetë, faktike, dhe të matur, duke u përpjekur për të zvogëluar aspektet emocionale të lajmeve përderisa plotësisht informoi shikuesit e tij. Karakteri i mbulimit të ngjarjeve në TV 21 ishte i cilësisë tjetër, dhe më i përgjegjshëm e profesional se sa i RTK-së.

REKOMANDIMET LIDHUR ME TV 21

- 1. Trajnimet dhe diskutimet e raportimit të konfliktit:** Sikurse shumica e mediave të Kosovës, TV 21 do të përfitonte nga trajnimet specifike për korrespondentë dhe redaktorë në teknikat dhe etikën e raportimit të konflikteve. Rëndësia e kërkimit, dhe prezentimit të tërësishëm, të këndvështrimit të policisë në çfarëdo incidenti duke përfshirë vdekjen apo lëndimin – posaçërisht kur faktorët etnik mund të jenë të përfshirë - nuk mund të jenë të theksuar mjaft.

TMC

KOMISIONERI I PËRKOHSHËM PËR MEDIA
PRIVREMENI KOMESAR ZA MEDIJE
TEMPORARY MEDIA COMMISSIONER

SHTOJCA
TRANSKRIPTET: RTK-KTV-TV21 – 16-17 MARS

RTK

16 mars 2004

20:30

[Lajmi i titruar në ekran]:

Tre fëmijët e zhdukur në ujrat e lumit Ibër janë: Florent Veseli 8 vjeç, Avni Veseli, 11 vjeç, Egzon Deliu 12 vjeç. Është gjetur ndërkaq, Fitim Veseli 14 vjeç. Sipas njoftimeve të deritashme, ata janë viktimat e sulmit të serbve në fshatin Çabër. Ekipi ynë gjendet në vendin e ngjarjes dhe së shpejti mund të ndiqni edicionin special të lajmeve përfshirë edhe intervistën me Fitim Veselin i cili është dëshmitar i ngjarjes.

[E dhënë tri here]

RTK

16 mars 2004

22:28

*Edicioni Special***Raporton Rozafa Metaj nga Mitrovica, pranë lumit**

Forca të mëdha të KFOR-it, Shërbimit Policor të Kosovës, dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës janë mbledhur këtu në fshatin Binaq të komunës së Mitrovicës në kërkim të trupave të Florent Veselit, (8), Egzon Deliut, (12), dhe Avni Veselit (11), të cilët rreth orës 18:00 kanë rënë në ujërat e lumit Ibër në komunën e Mitrovicës, në fshatin Çabër.

[Pamje nga lumi, policia dhe autoambulanca e KFOR-it Danez][51 sec.]

Tracy Becker, UNMIK

Fillimisht ka pasur zëra të cilët kanë thënë se incidenti kishte ndodhur për motive etnike, pasi që për momentin ne nuk kemi një informacion të tillë këtë gjë ne nuk mund ta konfirmojmë. (12 sec)

Intervistë me Fitim Veseli

Gazetari: Fitim a mund të na tregosh ngjarjen se si ka ndodhur sot?

F: Po kemi qenë pra me disa kushërinj të mij duke shëtitur dhe me disa shokë të mij dhe jemi shkuar afër lumit, kur disa serbë me një qen na u kan, psh, na kan shajit prej shtëpisë. I kemi kqyr ata, unë i njoh me i pa dhe shtëpinë ua njoh dhe na jemi munoft me ik po s'kemi mujt e kemi qenë afër lumit. Kam pas edhe vëllaun tem i cili ka qenë Florent Veseli, 9 vjecar, ai nuk ka dit not. E kam qit në shpinë, kam notu 15 metra ma shumë s'kom mujt.

M'ka ra prej shpine nuk di ma për atë asgje, ata dy tjeret kanë notu para meje, as për ata dy nuk di asgjë dhe janë kanë edhe dy që nuk janë hi në Iber fare, ata ishin më larg se na d.m.th ma larg urës aty ka qenë ora kah 4:00 , 3:55 dhe aty u kanë një serb i fshehur në kallamoq si me thanë, dhe ne jemi munoft që ti tregojme atyre që të ikin, i kemi thirrur po ata nuk na kane ndëgju, nuk na kanë ndier dhe ne kemi kcyer në Iber por ata ishin pshtu, nuk e di si kanë pshtu ata tjerët por vllaun time që e kam pas në shpine, më ka ra se valët e mdhaja, libri i madh mka ra prej shpine jam dal diqysh i lodhët prej lbrit.

Gazetari: Kush të ka ndihmu me dal prej lumit?

F: Vetë jam dal. (1.42)

[Pamje nga lumi duke treguar njësitë mjekësore të KFOR-it]

RTK

16 mars 2004

23:15

BLIC [programi i lajmeve në orët e vona të mbrëmjes sipas skemës programore]

Prezantuesja (Ramize): Tre fëmijë shqiptarë, Florent Veseli, 8 vjeç, Avni Veseli 11 vjeç dhe Egzon Deliu, 12 vjeç, janë zhdukur në ujërat e lumit Ibër ndërkaq Fitim Veseli 14 vjeç është gjetur. Ata janë viktimë të një sulmi të një grupi të serbëve në fshatin Çabër. Policia, KFOR-i dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës janë duke kërkuar për fëmijët e zhdukur. Para se të ndjekim materialin e përgatitur po lidhemi drejtpërdrejt me reporterin tonë në vendin e ngjarjes Petrit Musollin.

Prezantuesja: Alo, Petrit a po dëgjohemi?

Petrit: Po Ramize

Prezantuesja: Petrit a ka ndonjë lajm të ri?
(Pamje që tregojnë një rëz në urë praën lumit, automjete të KFOR-it dhe KPM-së)

P: Policia, KFOR-i dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës ende nuk kanë gjetur trupat e tre fëmijëve të zhdukur në lumin Ibër pasi që kanë rënë, që i kanë ndjekur një grup i serbëve. Policia momentalisht, KFOR-i dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës kanë vendosur disa rrjeta afër urës së Binaqit në Koshtovë në lumin Ibër duke pritur që të kapen trupat e pajetë të fëmijëve Florent Veseli, 8 vjeç, Avni Veselit 11 vjeç dhe Egzon Deliu, 12 vjeç, mirëpo policia nuk ka treguar nëse janë duke u kërkuar trupat e këtyre fëmijëve edhe në vendet tjera. Deri më tash policia nuk ka sqaruar as nuk ka dhënë asnjë informacion më shumë sesa rrëfimi i Fitim Veselit i vetmi i cili është gjetur. Policia thotë se krejt informacionet cka kemi i kemi vetëm nga rrëfimi i Fitim Veselit. Këto janë informacionet me të reja, policia, KFOR-i dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës janë ende duke kërkuar trupat dhe kanë premtuar se do të lajmërojnë porsa të kenë informacione të tjera. Po Ramize?

Prezantuesja: Po çfarë është situata në Mitrovicë, a është nën kontroll, çfarë janë reagimet e qytetarëve?

P: Në qytetin e Mitrovicës, momentalisht situata është e qetë pasi që pothuajse të gjithë qytetarët janë të drejtuar nga fshati Çabër për të mësuar për fatin e tre fëmijëve të zhdukur në lumin Ibër. Mirëpo vërehen lëvizje në qytet, lëvizje të policisë dhe KFOR-it e sidomos herë pas here qyteti vëzhgohet nga një helikopter ushtarak i KFOR-it. Mirëpo policia më shumë është e përqëndruar rrugës që qon prej qytetit të Mitrovicës në fshatin Çabër dhe sidomos pranë shtëpive ku janë të vendosur serbët prej nga edhe i kanë sulmuar fëmijët të cilët i

kanë detyruar që të hudhen për të shpëtuar në lum. Këto janë informacionet më të reja.

Prezantuesja: Petrit, ndoshta para përfundimit të këtij edicioni do të lidhemi edhe njëherë me ju, ndërkohë ne shikues të nderuar tani do të ndjekim materialin e përgatitur rreth ngjarjes tragjike që ndodhi në fshatin Çabër të Mitrovicës. (2.16 min.)

Raporton Rozafa Metaj nga Mitrovica, pranë lumit [Përsëritje]

Forca të mëdha të KFOR-it, Shërbimit Policor të Kosovës, dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës janë mbledhur këtu në fshatin Binarc të komunës së Mitrovicës në kërkim të trupave të Florent Veselit, 8 vjeç, Egzon Deliu, 12 vjeç, dhe Avni Veselit 11 vjeç, të cilët rreth orës 18:00 kanë rënë në ujërat e lumit Ibër në komunën e Mitrovicës, në fshatin Çabër. *[Pamje nga lumi, policia dhe autoambulanca e KFOR-it Danez][51 sec.]*

Tracy Becker, UNMIK [Përsëritje]

Fillimisht ka pasur zëra të cilët kanë thënë se incidenti kishte ndodhur për motive etnike, pasi që për momentin ne nuk kemi një informacion të tillë këtë gjë ne nuk mund ta konfirmojmë. (12 sec)

Intervistë me Fitim Veseli [Përsëritje]

R: Fitim a mund të na tregosh ngjarjen se si ka ndodhur sot?

F: Po kemi qenë pra me disa kushërinj të mij duke shëtitur dhe me disa shokë të mij dhe jemi shkuar afër lumit, kur disa serbë me një qen na u kan, psh, na kan shajt prej shtëpisë. I kemi kqyr ata, unë i njoh me i pa dhe shtëpinë ua njoh dhe na jemi munoft me ik po s'kemi mujt e kemi qenë afër lumit. Kam pas edhe vëllaun tem i cili ka qenë Florent Veseli, 9 vjecar, ai nuk ka dit not. E kam qit në shpinë, kam notu 15 metra ma shumë s'kom mujt.

Mka ra prej shpine nuk di ma per atë asgje, ata dy tjeret kanë notu para meje, as për ata dy nuk di asgje dhe janë kanë edhe dy që nuk jane hi në iber fare, ata ishin më larg se na d.m.th ma larg urës aty ka qenë ora kah 4:00 , 3:55 dhe aty u kanë një serb i fshehur në kallamoq si me thanë, dhe ne jemi munoft që ti tregojmë atyre që të ikin, i kemi thirrur po ata nuk na kanë ndëgju, nuk na kanë ndier dhe ne kemi kcyer në lber por ata ishin pshtu, nuk e di si kanë pshtu ata tjerët por vllaun time që e kam pas në shpine, më ka ra se valët e mdhaja, lbri i madh m'ka ra prej shpine jam dal diqysh i lodhët prej lbrit.

R: Kush të ka ndihmu me dal prej lumit?

F: Vetë jam dal. (1.42)

[Pamje nga lumi duke treguar njësitë mjekësore të KFOR-it]

Intervistë me Halit Berani [në studio në Prishtinë]

Prezantuesja: Në studio është kryetari i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Mitrovicë, Halit Berani.

Prezantuesja: Z. Berani, cilat janë informacionet që keni ju rreth këtij rasti?

H.B.: Sot rreth orës 16 në fshatin Çaber të Zubin Potokut derisa ishin duke lozur 6 fëmijë të fshatit në fjalë, një grup banditësh serb i sulmojnë këta fëmi, banditët serb kishin qenë edhe me një qen, dhe duke ua sharë nanen shqiptare dhe kështu i kanë detyruar të ikin fëmijët shqiptarë, dy prej tyre kanë arritur të fshihen në rrënjët e shelgjeve buzë lumit lumëbardhë, ndërsa 4 të tjerë kanë ra në ujë, dihet se lumi lumëbardhë është përveç që është shumë i thellë është ujtë e ftoftë, dhe është tepër i rreptë, dhe fëmija sigurisht nuk kanë ditur shumë mirë not dhe tre prej tyre nuk dihet për fatin e tyre ndërsa një ka shpëtu pasi që ka arritur të dal në pjesën tjetër të lumit.

R: Po cili është reagimi juaj si këshill rreth kësaj ngjarje tragjike?

HB: Po ne me këto u mësum se banditët serb përveç këtij rasti edhe në orën 19 e 7 minuta sot në mbramje në lagjen 7 shtatorit hodhën bomba në afërsi të tre rrokaqiejve dhe kto janë, ne mendojmë se janë si hakmarrje të rastit që ndodhi në Çagllavicë, rastit të inskenuem se për cka janë të prirë serbët, atherë kur fillon të qetësohet pak gjendja në Kosovë ata inskenojnë me çdo kusht dhe se nuk ju konvenon gjendja e stabilizuar në Kosovë.

R: Zoti Barani faleminderit,

HB: Ska për se. (1.46 min.)

P: Ne vazhdojme me informacionet e tjera të këtij edicioni.

“Lajmet flesh” [Pjesa tjetër e programit]

Me moton “Të gjithë në mbrojtje të çlirimtarve të Kosovës” në 27 qendra të Kosovës janë mbajtur protesta.

Me moton “Të gjithë në mbrojtje të çlirimtarve të Kosovës” në ora 13 në 27 qendra të Kosovës janë mbajtur protesta gjithëpopullore të cilat zgjatën dy orë. Në këto protesta u kërkua nga institucionet vendore dhe ato ndërkombtare që të mos shkelet mbi vlerat e luftës çlirimtare. Protestuesit mbanin fotografitë e ish-luftëtarëve të UÇK-së që tashmë ndodhen në burgje si dhe pankartat me mbishkrime “**Poshtë ligjet e Serbisë në Kosovë**” “**Stop administrimit serb – unmik**” etj. Protestuesit kanë bërë thirrje për ndërprerjen e politikës së UNMIK-ut ndaj çlirimtarëve përderisa herë pas herë është brohoritur edhe për largimin e UNMIK-ut nga Kosova. Në asnjërën prej protestave të mbajtura në shumicën e

komunave të Kosovës nuk është raportuar për ndonjë incident. *[Pamje nga protestat] [39 sec.]*

Serbët vazhdojnë të mbajnë të bllokuar rrugën që shpie në Çagllavice.

Qindra serb të Çagllavices edhe sot kanë vazhduar të mbajnë të bllokuar magjistralen Prishtinë - Shkup, në shenjë proteste pas plagosjes së serbit Jovica Ivic. Serbë të mbledhur në Çagllavicë dhe Graçanicë kanë shkaktuar disa incidente, për pasojë një policë ndërkombtar është lënduar ndërsa mbrëmë janë sulmuar edhe disa ushtrarë të KFOR-it. Poashtu njoftohet se turma e njerëzve mbrëmë kanë ndaluar një veturë dhe i kanë vënë zjarrin ndërsa janë dëmtuar edhe disa vetura të tjera përfshirë edhe një veturë të policisë së UNMIK-ut. Sipas zyrtarëve të policisë për shkak të dhunës, sulmi ndaj të riut serb është dënuar ashpër nga kryetari Ibrahim Rugova dhe Kryeministri Bajram Rexhepi.

[Pamje nga Çagllavica – protestat e serbëve] [33 sec]

Ka vazhduar vizitën në SHBA, kreu i PDK-së Hashim Thaqi

Sipas tij të gjitha takimet e zhvilluara në Amerikë kanë qenë të përqëndruara në zbatimin e standardeve. Thaqi ka kërkuar nga SHBA që ta ndihmojnë Kosovën në zbatimin e këtyre standardeve. Paqartësia rreth statusit të Kosovës po ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e Kosovës ka thënë Thaqi. (24 sec)

Ministri Jakup Krasniqi mohon akuzat e bëra nga Ministria e Financave

Ministri i Shërbimeve Publike Jakup Krasniqi ka mohuar akuzat e bëra nga Ministria e Financave se gjatë vitit 2002 janë bërë 6 blerje një burimore që nënkupton se për ato nuk është shpallur tender. Ministria e Shërbimeve Publike nuk i ka 6 tender me blerje direkte një burimore por janë vetëm dy tender kontrata, kështu ka thënë në takimin me gazetarë Ministri Jakup Krasniqi. Sipas Krasniqit të gjitha shkresat, kontratat, fletëporositë duke përfshirë edhe aprovimin e blerjeve direkte një burimore janë të nënshkruara dhe të aprovuara nga zyrtarët ndërkombtar. (29 sec)

Lajmet e tjera

Qeveria e Kosovës, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura dhe Oda Ekonomike e mbajtën një takim ku theksi i veçant iu kushtua kontratës kolektive për punëtorët në Kosovë e cila do të përgatitet deri në 12 maj.

Kosova në një minutë

Rajoni në një minutë

Bota në një minutë

Kultura

Moti

Koha

Lajmet më të reja nga Mitrovica

Prezantuesja: Po lidhemi sërish me reporterin tonë në Mitrovicë Petrit Musollin. Petrit a po dëgjohemi?

P: Po Ramize

Prezantuesja: A ka tani ndonjë lajm të ri apo çfarë është situata?

P: Ende nuk ka ndonje lajm të ri rreth fatit të tre femijeve të humbur në ujrat e lumit Ibër, policia e KFOR-it dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës janë duke kërkuar trupat e tyre mirpo të themi se gazetarët janë të kufizuar të marrin informacione drejtpërdrejt nga vendet e kërkimit për shkak se policia nuk i ka lejuar asnjë gazetari që ta percjell ngjarjen për së afërmi nga vendet ku pritet të gjinden trupat e pajetë të tre fëmijeve të humbur. Kështu që ne jemi të varur vetëm nga zëdhënesit e policisë së UNMIK-ut në fshatin Çaber të cilët do të lajmrojnë nëse do të ketë ndonjë risi.

P: Ndërkohë pas ores 24 do të kemi një emision special që ekipet tona janë duke u përpjekur për transmetim të drejtpërdrejt nga Mitrovica.

[Pamje nga lumi, policia, KFOR-i] [40 sec]

RTK

17 mars 2004

01:10

Edicioni Special

Prezantuesja (Ramize): Rreth një kilometër nga vendi i ngjarjes në fshatin Koshtovë të komunes së Mitroviceës në ujrat e lumit Ibër është gjetur trupi i pajetë i Egzon Deliut 12 vjeçar, ndërkohe ende nuk dihet asgjë për fatin e dy femijeve të tjerë të zhdukur në këtë tragjedi Florent Veseli 8 vjeç dhe Anvi Veseli 11 vjeç. Ata ishin viktimat të sulmit të një grupi të serbëve në fshatin Çabër. Policia, KFOR-i dhe TMK janë duke kërkuar fëmijët e tjerë. Në lidhje të drejtpërdrejt nga Mitrovica kemi reporterin tonë Petrit Musollin.

Prezantuesja: Cilat janë më të rejtat nga Mitrovica?

P: Siç e thatë edhe ju nga disa burime tona këtu në vendin e ngjarjes supozohet se është gjetur trupi i Egzon Deliut 12 vjeçar, njëri nga tre fëmijët e zhdukur në ujrat e lumit Iber. Mirpo kjo nuk është konfirmuar nga policia, policia madje nuk ka informuar as nuk ka dhënë as ndonjë hollesi lidhur me procesin e kërkimit. Deri me tash ende nuk dihet nëse policia ka gjetur edhe ndonjë trup tjetër. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 3 e gjysmë ku 6 fëmijë kanë qenë duke lozur dhe janë ndjekur nga një grup serbësh të cilët iu kanë lëshur edhe qen. Fëmijët duke mos mundur t'i shpëtojnë ndjekjes së grupit të serbëve si të vetmin shpëtim kanë gjetur të kërcejnë në lumin Ibër. Lumin ka arritur ta kalojë vetëm Fitim Veseli, 14 vjeçar ndërkaq tre fëmijët e tjerë Florent Veseli 8, Egzon Deliu 12 dhe Avni Veseli 11 vjeçar kanë mbetur nën ujrat e lumit Ibër. Këto janë të gjitha informacionet...

Prezantuesja: Siç duket kishim shprehje të lidhjes telefonike ndërkohë ne do të mundohemi ta marrim edhe një herë në lidhje të drejtpërdrejt kolegun tonë. Mirpo tani vazhdojmë me deklaratën e të mbijetuarit Fitim Veselit.

Intervista me Fitim Veselin [përsëritje]

Gazetarja: Fitim a mund të na tregosh ngjarjen se si ka ndodhur sot?

F: Po kemi qenë pra me disa kushërinj të mij duke shëtitur dhe me disa shokë të mij dhe jemi shkuar afër lumit, kur disa serbë me një qen na u kan, psh, na kan shajt prej shtëpisë. I kemi kqyr ata, unë i njoh me i pa dhe shtëpinë ua njoh dhe na jemi munoft me ik po s'kemi mujt e kemi qenë afër lumit. Kam pas edhe vëllaun tem i cili ka qenë Florent Veseli, 9 vjeçar, ai nuk ka ditë not. E kam qit në shpinë, kam notu 15 metra ma shumë s'kom mujt.

Mka ra prej shpine nuk di ma për atë asgjë, ata dy tjerët kanë notu para meje, as për ata dy nuk di asgjë dhe janë kanë edhe dy që nuk janë hi në lber fare, ata ishin me larg se na d.m.th ma larg urës aty ka qenë ora kah 4:00, 3:55 dhe aty u kanë një serb i fshehur në kallamoq si me thanë ,dhe ne jemi munoft që ti tregojmë atyre që të ikin, i kemi thirrur po ata nuk na kanë ndëgju, nuk na kanë ndier dhe ne kemi kcyer në lber por ata ishin pshtu, nuk e di si kanë pshtu ata tjerët por vllaun time që e kam pas në shpinë, më ka ra se valët e mdhaja, lbri i madh mka ra prej shpine jam dal diqysh i lodhët prej lbrit.

Gazetarja: Kush të ka ndihmu me dal prej lumit?

F: Vetë jam dal. (1.42)

Prezentueja: Ne artem të lidhemi edhe nje herë drejtpërdrejte me reporterin tonë nga vendi i ngjarjes, Petrit Musollin. Petrit qytetarë të shume kanë dal në pritje te informacioneve më të reja për fatin e këtyre fëmijeve, çfare është situata atje?

P: Situata momentalisht është e qetë mund të themi se është e qetë për shkak se të gjithë banorët janë të hutuar duke pritur, që të mësojnë për fatin e këtyre tre fëmijëve, mirpo shihet një revoltë e banorëve sidomos ndaj policisë së UNMIK-ut sepse në mesin e policëve të UNMIK ka edhe policë të minoritetit serb të cilët kohë pas kohe flasin me zëra të lartë për tu dëgjuar kështu që banorët janë provokuar janë ndjerë të provokuar nga kjo, por ne momentalisht po themi se situata është e qetë sa që të gjithë janë hutuar duke pritur të mësojnë për fatin e tre fëmijeëve të humbur edhe pse siq thamë më herët thuhet se njëri, Egzon Deliu, trupi i pajetë i Egzon Deliu është gjetur, mirpo ende nuk është konfirmuar as familja dhe askush nëse trupi i është dorëzuar apo është gjetur në të vërtet trupi i Egzon Deliu, Policia nuk e ka konfirmuar këtë as familjes së tij.

Prezentesja: Petrit, faleminderit për këto informacione.

Shikuesë të nderuar rreth orës 1 e 30 presim të lidhemi drejtpërdrejt nga vendi i ngjarjes.

[Shënim: Nuk ka prezentim tjetër të këndvështrimit të policisë së UNMIK-ut]

RTK

17 mars 2004

01:35

Edicion Special

Petrit Musolli: Po lajmërohem drejtpërdrejt këtu nga ura e Binarcit ku policia, KFOR-i dhe Trupat e Mbrojtjes së Kosovës janë ende duke bërë përpjekje për të gjetur trupat e zhdukur të tre fëmijëve shqiptarë në ujrat e lumit Ibër. Edhe pse sipas burimeve tona këtu supozohet se është gjetur trupi i Egzon Deliut 12 vjeçar, mirëpo këtë nuk e ka konfirmuar policia. Policia nuk ka dhënë as ndonjë informacion lidhur me procesin e kërkimit të trupave të tre fëmijëve shqiptar të zhdukur në ujrat e lumit Ibër, policia nuk ka konfirmuar gjithashtu nëse ka ndonjë të arrestuar apo është në ndjekje të ndonjë të dyshuari që ka quar këta fëmijë në tragjedi. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 15:30 kur këta fëmijë përderisa po luanin janë ndjekur nga një grup serbësh të cilët iu kanë lëshuar edhe qenjt, fëmijët duke mos mundur t'i shpëtojnë ikjes së këtyre serbëve janë detyruar të kërcejnë në lumin Ibër. Lumin ka arritur ta kalojë vetëm Fitim Veseli 14 vjeçar, dhe tre fëmijët tjerë Florent Veseli 8 vjeçar, Agim Veseli 11 vjeçar, Egzon Deliu 12 vjeçar kanë mbetur nën ujërat e lumit Ibër.

Intervistë me Halit Barani. (Gazetari i RTK-së: Petrit Musolli)

P: Këtu për të biseduar më hollësisht se çfarë ka ndodhur, kemi edhe zotin Halit... A mund të na thoni se çfarë ka ndodhur konkretisht?

HB: Sipas deklaratës së fëmiut i cili ka shpëtuar nga kjo tragjedi, rreth orës 16:00 derisa ishin duke lozur 6 fëmijë shqiptar, banorë të lagjës, të fshatit Çaber të Zubin Potokut një grup banditësh serb të cilët me vete kishin pas dhe qen i kanë sulmuar fëmijët duke ua sharë nga larg nënën shqiptare dhe kur kanë filuar të vërsulen mbi ta, dy prej tyre kanë arritë të fshihen në disa rrënjë të shelgjeve ndërsa katër tjerë janë hedh në ujë nga frika për çka, për tre nuk dihet për fatin tyre ende ndërsa njëri ka shpëtuar, ka arritur të del në pjesën tjetër të lumit.

P: Z. Barani mos keni ndonjë informacion shtesë se deri ku ka shkuar procesi i kërkimit për shkak se policia ka thënë se përveq atë që ka thënë Fitim Veseli i shpëtuar i vetëm nuk ka informacione tjera?

HB: Po, jo sipas TMK të cilët deri tash kanë gjurmë dhe vazhdimisht gjurmojnë, edhe Egzoni është zbulu, trupi i tij i pa jetë dhe tash është në duar të policisë.

PM: Supozohet se njësitet e TMK-së e kanë gjetur trupin e Egzon Deliut 12 vjeçar, keni ndonjë informat lidhur me këtë.

HB: Po tash sapo bisedova me një komandant të TMK-së dhe ai konfirmoi se trupin e pajetë të Egzonit e kanë gjetur Trupat Mbrojtëse të Kosovës, dhe vazhdimisht janë duke gjurmuar Trupat e Mbrojtjes së Kosovës së bashku me zjarrëfiksitë, KFOR-in dhe policinë.

PM: Mund të na thoni z. Barani se cili ka qenë reagimi në ato momente i banorëve të fshatit Çabër pasi që është lajmëruar rasti se janë zhdukur këta tre fëmijë?

HB: Ajo dihet se çfarë reagimi, kur në një tragjedi të tillë dihet se si kish me reague jo vetëm banorët e fshatit Çabër që iu ka ndodhur tragjedia por edhe atyre të cilëve nuk ju ka ndodh por që kanë ndëgjuar për këtë rast sigurisht se janë të mllfosur e posaqërisht për raste të tilla ku ky rast supozohet se është hakmarrje e rastit të plagosur të serbit që ndodhi në Çagllavicë ku ai ishte një inskenim për çka serbët janë të prirë për gjëra të tilla sa herë që fillon të stabilizohet gjendja në Kosovë ata gjejnë forma të ndryshme dhe bëjnë inskenime të tilla për ta destabilizuar gjendjen.

PM: Faleminderit z. Barani

H: Me nder çofshit.

RTK

17 mars 2004

02:37

Edicioni Special

Prezantuesi: [nuk ndëgjohej]

Reporteri: Po lajmrohemi sërish drejtpërdrejt këtu nga vendi i ngjarjes. Këtu me ne është babai i Egzon Deliu, Zaim Deliu. Egzon Deliu është djali i vetëm i Zaimit pas 7 vajzave. Z. Deliu a mund të na thoni a keni lajme të reja për fatin e djalit tuaj?

Zaim: Djali jem ditën e kobshme sot u gjind i vdekur nga hordhit çetnike serbe ...por e mbytën në menyrën ma mizore duke e shtirë që me zor të hudhet në këtë lum ...

Sa e sa herë në male kur kane dal ju kanë kërcnue kur kan shkue në teritore tona që i kena atje prej Jegenice ju kan flug kur kane dalë rrugës ndonjëherë, rrugës tu shku i kanë njëk gjithë e sot i njëkën perfundimisht. [pjesa tjetër nuk dëgjohej]

Reporteri: A mund t'na thoni se kur e keni marr lajmin dhe kush ju ka kumtuar lajmin?

[pjesa tjetër nuk dëgjohej]

[Babai i djalit të vdekur ishte xhiruar së bashku me Halit Baranin, e cili e mbante për krahu.]

Njeriu i panjohur në ekran: Para një gjysmë ore e gjetëm trupin e Egzon Deliu, kështu që unë me sytë e mi e pash dhe e konfirmova vdekjen e tij.

RTK

17 mars 2004

06:01

Video teksti i lajmeve, vendi: Mitrovica

Tre fëmijë shqiptarë, Florent Veseli 8 vjeç, Avni Veseli 11 vjeç dhe Egzon Deliu 12 vjeç, janë zhdukur në ujrat e lumit Ibër, ndërsa Fitim Veseli, dëshmitar i ngjarjes ka thënë se ata janë ndjekur me qen nga një grup serbësh të veriut të Mitrovices. Ai thotë se ka arritur të shpëtoj pasi që ka ditur të notoj, ndërsa për të tjerët ai vetëm konfirmon se kanë rrënë në ujë bashkë me të dhe më s'i ka parë.

Policia dhe KFOR-I janë duke kërkuar për tre femijët e tjerë të zhdukur. Sipas njoftimeve situata në Mitrovicë është e tensinuar.

KTV

17 mars 2004

01:00

Emisioni Special (5 min. 5 sec)

[Shënim: Ky edicion i lajmeve u shfaq pa paralajmërim në studio]

Reporteri: Bashkim Vishaj

(pamjet nga ura e Ibrit dhe pjestarët e Policisë së UNMIK-ut, KFOR-it dhe SHPK-së, pastaj pamjet zhvendosen në shtepinë e familjes Veseli në Çabër ku shihen anëtarët e pikëlluar të familjes).

(intervista me djaloshin e mbijetuar, i ulur vetëm në shtrat)

Fitimi: Quhem Fitim Veseli jam 13 vjeçar.

Reporteri: A mundesh me na tregu se çka ka ndodhur, dhe si ka ndodhur, a të kujtohet?

F: Po ishim duke shetitur anena matanë lumit dhe kur disa serbë, dmth dy serbë deshtën të na sulmojnë, por sa për ata ne kishim shpëtuar por kishin edhe një qen. Se ne kishim frike prej atij se prej shkijev jo se ju kishim shpëtuar atyre se ishin shumë larg por qeni vrapojke shpejt dhe ne ishim afër lumit, isha unë ,vëllau im Florent Vesli 9 vjeçar, dhe dy shokët e mi Avni Veseli 11 vjeçar, dhe Egzon Deliu 12 vjeçar. Kur e trupuam Ibrim ata dy hinën të parët ndërsa unë vëllaun tim e qita në shpinë se ai nuk dike not dhe gjithëkund ishte thellë unë gjith rrijsha me kry të zhytur në ujë, veç kur dikun ishte plitko pak u qojsha edhe marsha frymë. Se nuk mujsha se ai ishte i rëndë.

Përnjherë më shpëtoi nga shpina dhe mora not shumë shpejt dhe e nxana por dikur ishte shume thellë me shpëtoi nga shpina apet, s'mujta me gjetë dhe kur dola në stom të lumit aty kqyra dhe më nuk e pashë kërkun dhe i pash shkijet duke lypën për anena për neve në stom të Ibrit, ndërsa të dy shokët tjerë që nuk kishin hyrë në lum Florim Veseli dhe Qamil Zeqiri ata ishin duke shetitur para neve dhe ndërsa një serb, ishte plak ai serb, ishte në kallamoq i fshehur.

Na e pamë që u fsheh dhe deshtëm që t'ju trojmë atyre por ata nuk na dëgjoishin se ishin shume larg, dhe qështu na e trupum Ibrin dhe ata serbët tu na lyp neve ata për fat nuk i kanë takuar ata të tjerët.

R: Sa vete keni qenë ju duke luajtur dhe sa keni shpëtuar prej atij incidenti?

F: Na kemi qenë 6 vetë, dhe tre kemi shpëtuar ndërsa për tre fatin e tyre nuk dihet.

R: Qysh ke mujt me arritë me ardh deri në shtëpi?

F: Kom mujt me arritë vetë, nuk më ka ndihmuar kërkush, menxi jom ardh, isha në stom të lbrit aty kur i pashë shkijet duke lypur për neve. Unë u qova, pak eca dhe shkova te djali i mixhës Driton Veseli. Atij i tregova dhe ai pastaj i lajmëroi policisë e Kforin e tjerët.

Tracy Becker –UNMIK (deklarata e dhënë gazetarit)

Krejt çka dijmë për momentin është se janë zhdukur tre fëmijë. Kemi marrë informacionin se në lumin Ibër kanë rënë 4 fëmijë mirëpo fatmirësisht njëri nga ata ka shpëtuar dhe gjendet në shtëpinë e tij. Moshë e këtyre fëmijëve e dijmë se është 9 deri 12 vjec. Ne edhe më tutje jemi në kërkim të trupave të tjerë dhe se motivi i këtij incidenti nuk dihet.

[Shifen kuadro të ardhjes së pjestarëve të TMK-së si dhe Oficeri i TMK-së duke dhënë urdhërin për kërkim- shpëtim]

Zëri i Oficerit të TMK-së: *Me rrjeta është regullu, kërkim-shpëtimi është prej urës. Ju duhet prej këtij vendi ku ka ndodh aksidenti të lëshoheni deri sa të takoheni me ekipet e kërkim-shpëtimit. Hulumtoni nëse duhet hyni edhe në ujë, lidhuni me litare, radiolidhjet i keni dhe lajmëroni për çdo eventualitet.*

[Përfundon me kuadrot e pjestarëve të TMK-së të cilët nisen për ta zbatuar urdhërin]

TV 21

16 mars 2004

22:00

Lajmet flesh (15 min)**Lajmet kryesore:**

1. Serbët bllokuan rrugët në Gracanicë dhe Çagllavicë dhe keqtrajtuan disa udhëtarë shqiptarë.
2. Presidenti Rugova dhe Kryeministri Rexhepi dënuan sulmin e mbrëmshëm në Çagllavicë
3. Në Prishtinë dhe në qendra të tjera të Kosovës, u mbajtën protesta me moton "të gjithë në mbrojtje të luftës çlirimtare".(17 sec.)

Lajmi i parë: Çabër / Mitrovicë

Prezantuesi: Sot rreth orës 16:00 në fshatin Cabër dy serbë kanë ndjekur katër fëmijë shqiptarë dhe gjatë përpjekjeve për t'ju ikur atyre fëmijët janë hedhur në lumin Ibër. Për të mësuar më në hollësi në linjë telefonike kemi korrespondentën tonë në Mitrovicë, Mirlinda Jashari

Prezantuesi: Mirlinda po dëgjohemi?

Mirlinda: Po, po dëgjoheni.

Prezantuesi: Cilat janë informacionet e fundit nga fshati Çabër?

Mirlinda: Po, rreth orës 16 të ditës së sotme në fshatin Çabër të Komunës së Zubin Potokut, fshat i vetëm i banuar më shqiptarë në këtë komunë, druhet të ketë ndodhur një tragjedi e rëndë. Sic rrëfen fëmiu 13 vjeçar Fitim Çerkin Veseli nga ky fshat, në këtë kohë ai dhe 5 moshatarë të tij kishin qenë duke shëtitur matanë lumit Ibër. Në ato caste nga një shtëpi serbe kanë dalur dy persona të cilët kishin me vete një qen dhe kanë filluar t'i ndjekin fëmijët. Nga frika 4 nga fëmijët kanë kërcyer në lumin Ibër me shpresë se duke notuar do ta kalojnë atë. Mirëpo, meqë uji kishte qenë i rrëmbyeshëm lumin arrin ta kalojë vetëm Fitim Veseli kurse për Fatim e Egzon Deliut, 12 vjeçar, Avni Veselit 11 vjeçar dhe Florent Veselit 9 vjeçar akoma nuk dihet asgjë. Edhe në këto caste kur po raportoj nga vendi i ngjarjes, pra nga fshati Çabër ekipet e shpëtimit të KFORIT, policisë së UNMIK dhe SHPK-së janë duke kërkuar në lumin Ibër, prej Çabrës deri në Mitrovicë, mirëpo për fatin e këtyre fëmijëve deri tash nuk dihet asgjë.

Prezantuesi: Mirlinda, sonte rreth orës 19 në Mitrovicë ka ndodhur një shpërthim. Cilat janë pasojat?

Mirlinda: Po, sot rreth prës 19:10 në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës prapa 3 rrokaqiejve në rrugën për Suhodoll ka ndodhur një shpërthim i fuqishëm i cili ka shqetësuar tej mase banorët e atjeshëm. Mirëpo, ky shpërthim fatmirësisht nuk ka shkaktuar viktima e as dëme materiale. Ende nuk dihet pra se kush qëndron prapa këtij shpërthimi.

Prezantuesi: Falemnderit. Ishte pra kjo korrespondentja jonë në Mitrovicë, Mirlinda Jashari.

[Pamje nga arkivi të qytetit të Mitrovicës shiheshin në ekran gjatë raportimit telefonik (1 min. 48 sec)]

Lajmi i dytë: Graçanica dhe Çagllavica (bllokimi i rrugëve)

Prezantuesi: Serbët e Graçanicës dhe Çagllavicës mbajnë të bllokuara rrugët Prishtinë – Shkup dhe Prishtinë – Gjilan në shenjë revolte për sulmin e mbrëmshëm ndaj bashkëkombasit të tyre, Jovica Ivic. Ata e manifestuan revoltën edhe me akte të dhunshme. Një polici të UNMIK-ut dhe disa udhëtarëve shqiptarë u shkaktuan lëndime trupore. Negociatat për hapjen e rrugëve nuk kanë dhënë ende rezultat dhe rrugët vazhdonjë të mbeten të mbyllura. (21 sec)

Korrespondenti Shkumbin Ahmetxhekaj raporton nga rruga që qon në Çagllavicë:

Gjatë tërë ditës së sotme magjistrerja Prishtinë - Shkup ka mbetur e bllokuar si pasojë e protestave që serbët e fshatit Lapllasellë kanë ndërmarrë si shenjë revolte ndaj plagosjes së një të riu serb të këtij fshati. Ndërkohë që forca të mëdha të policisë së UNMIK, KFOR dhe SHPK-së që në orët e mëngjesit janë vendosur në hyrje të këtij fshati por pa mundur dot të zhbllkojnë trafikun në këtë segment shumë të rëndësishëm rrugor.

Serbët kanë protestuar dhunshëm duke u shkaktuar dëme makinave që kanë kaluar nëpër Graçanicë dhe Çagllavicë. Nexhat Shkodra, njëri nga udhëtarët që ka pësuar me makinën e tij gjatë kalimit nëpër Graçanicë na tregoi se si papritur është sulmuar tek po vinte në drejtim të Prishtinës. Për fat ai nuk është lënduar.

[Pamje nga rruga me autmjetet e UNMIK-ut, KFOR-it dhe automjete civile duke qëndruar në rradhë/ të bllokuara] [96.92 sec.]

Deklarata e një dëshmitari i sulmuar në Graçanicë derisa po voziste për në Prishtinë:

Rasti ka ndodhur në 7:10 kur jam nis rrugës për me shku në Kishnicë tek një kusheri. Aty te kisha, te ura në Gracanice dulen një masë e madhe e shkive të përgatitun dhe filluan me gjujt me gurë. Pat të lëndum para meje ma tepër, por e dashti fati që tash veç vetura m'u ka dëmtu ...

(Ai ishte brenda veturës së tij deri sa fliste. Pamjet të xhamit të përparmë të thyer të veturës] [76 sec.]

Reporteri vazhdon me pamjet nga rruga e bllokuar:

Zëdhënësi i UNMIK, Derek Chapel tha se dënon aktin kriminal të plagosjes së një të riu serb por gjithashtu dënon dhunën e ushtruar nga turma e serbëve të cilët sipas tij po pengojne zhvillimin e hetimeve. (8.63 sec.)

Deklarata e Derek Chapel (përpara ndërtesës së policisë së UNMIK-ut):

Korrespondenti: Rasti i plagosjes së një të riu serb ka ndodhur mbrëmë rreth orës 19:00 kur një i ri serb është qëlluar skaj magjistrales. Të parët që janë paraqitur në vendin e ngjarjes ishin pjesëtarët e KFOR-it, të cilët janë qëlluar me gurë nga turma e serbëve të mbledhur. Pas kësaj, KFOR dhe policia e UNMIK-ut që u paraqiten më vonë u detyruan të tërhiqen nga vendi i krimit pa mundur të fillojnë hetimet kriminale. Tumra më vonë bllokoi magjistralen dhe filloi hedhjen e gurëve mbi veturat që kalonin duke u shkaktuar dëme të vogla. Pas kësaj trafiku është ndërprerë dhe kjo gjendje ka vazhduar gjatë tërë natës. Në mëngjes, sërish një grup prej 200 serbëve ka bllokuar rrugën ku si rezultat i sjelljes së tyre të dhunshme një polic ndëkombëtar është plagosur dhe makina e tij ka pësuar dëme të konsiderueshme. Më tej Chapel tha se gjendja ka ndryshuar në orët e pasditës por sipas tij vetëm 30 serbë protestojnë ende.

Ai tha se gjatë tërë ditës kanë biseduar me serbët në përpjekje për të zhbllokuar rrugën.

Chapel: "E di se ky mund të jetë reagim emocional në lidhje me plagosjen e mbrëmshme. Ne dënojmë këtë akt si një krim të tmerrshëm por gjithashtu e dënojmë dhunën. Kjo dhunë po na pengon që të fillojmë hetimet dhe ende nuk kemi mundur të bëjmë hapin e parë në ndriçimin e këtij akti, shtoi Chappel. Ai tha se shpreson se së shpejti rruga do të zhbllokohet. [Pamjet e automjeteve të UN në rrugën e bllokuar][1 min. 9 sec.]

Korrespondenti vazhdon: Krahas pjesëtarëve të KFOR dhe policisë së UNMIK në mbikëqyrje të situatës morën pjesë edhe pjesëtarë të SHPK-së. (5.2 sec.)

Deklarata e Refki Morinës/Zëdhënës i SHPK-së /në zyrën e tij: Po, ne kemi punuar së bashku me KFOR, dhe policinë ndërkombëtare të UNMIK dhe punojmë vazhdimisht së bashku në mënyrë që siguria, niveli i sigurisë në tërë lëvizjen qytetare të jetë ashtu si duhet dhe kemi kordinu punët dhe veprimet së bashku me policinë ndërkombëtare dhe KFOR dhe SHPK do të thotë o kan në ato vende ku mendohet se do të jep kontributin më të madh në sigurinë e qytetarëve,

lëvizjeve të tyre, në udhëzimet e tyre që të mos shkojnë në drejtime të ndryshme për arsye se mund të jenë të rrezikuar. (e përcjellur me pamjet e automjeteve të patrullës së SHPK-së dhe policëve në rrugën e bllokuar] [30.5 sec.]

Korrespondenti: Edhe pse protesta e serbëve ka përfunduar në mesditë, këtu në fshatin Gracanicë sipas policisë rruga vazhdon të mbetet e bllokuar për shkak të rrezikshmërisë së lartë. Pjesëtarë të SHPK-së në Gracanicë ku ne arritëm të deptëronim përmes një rruge dytësorë, na bënë të ditur se protestuesit e sotëm ishin nxënës të shkollës së mesme dhe konfirmuan se në orët e mëngjesit ata kanë gjuajtur me gurë udhëtarët. Ata na thanë se rruga nuk mund të hapet së shpejti nga frika se situata mund të përkeqësohet dhe gjithashtu paralajmëruan se pritet që edhe nesër të protestat të vazhdojnë. [Korrespondenti flet para ndërtesës së UN-it, vijon me pamjet e automjeteve dhe rrugës së bllokuar në Çagllavicë] [29.6 Sec]

Prezantuesi në studio vazhdon me deklaratën e Holkerit: Kryeadministratori Hari Holkeri ka dënuar sulmin e mbrëmshëm në Çagllavicë. Ai ka theksuar se sulmet me motive etnike ose me motive të tjera nuk u shërbejnë interesave të asnjë komuniteti por e dëmtojnë imazhin e Kosovës. Shefi i UNMIK, e ka dënuar edhe mbylljen e rrugëve nga qytetarët serbë në Gracanice dhe në Çagllavicë. “E kuptoj frustrimin dhe zemërimin e njerëzve, por nuk mund ta pranoj dhunën e ushtruar pas këtij incidenti, kur disa njerëz bllokuan rrugën, ia vunë zjarrin një automjeit dhe nuk lejuan hyrjen e policisë dhe KFOR-it” ka theksuar Kryeadministratori Holkeri. [Pamje të PSSP duke dhënë deklaratë për shtyp] [30.73 sec]

Prezentuesi – deklarata e Rugovës: Edhe Presidenti Ibrahim Rugova ka dënuar plagosjen e të riut serb Jovica Ivic që ndodhi mbrëmë në Çagllavicë dhe ka kërkuar që ky akt kriminal të hetohet dhe përgjegjësit të nxirren para drejtësisë. Presidenti Rugova ka theksuar se në Kosovë duhet të ketë siguri për të gjithë qytetarët ndërsa incidentet kriminale duhet të hetohen nga organet për zbatimin e ligjit. Të gjithë qytetarët duhet të zillen në përputhje me dispozitat për sundimin e ligjit ka theksuar presidenti Rugova. [Material nga arkivi ku shihet Rugova duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve] [22.2 sec.]

Prezentuesi – deklarata e Bajram Rexhepit: Sulmin e mbrëmshëm në Çagllavicë e ka dënuar edhe Kryeministri Bajram Rexhepi. Aktet si ky i fundit nuk i shërbejnë paqes dhe zhvillimit të demokracisë në Kosovë, thuhet në deklaratën e Kryeministrit Rexhepi. Shtohet se bllokimi i rrugëve nuk është formë demokratike e të shprehurit të pakënaqësisë dhe u bëhet apel qytetarëve që ta respektojnë ligjin dhe t’i lejojnë organet kompetente që të kryejnë punën e tyre. [material nga arkivi ku shihet Kryeministrit siç duket duke dhënë deklarata për shtyp] [21.6 sec.]

Prezentuesi – deklarata e Dacit: Edhe kryetari i kuvendit, Nexhat Daci dënoi sulmin e djeshëm të qytetarit serb në një fshat në afërsi të Prishtinës dhe kërkoi

nga organet përkatëse që kryesit e kësaj vepre të ndyer të zbulohen dhe të përballen me gjyqësinë.

Kryeparlamentari Daci gjithashtu dënoi rastin e bllokimit të magjistrales Prishtinë – Shkup nga banorët lokalë duke konsideruar se veprimet e tilla nuk e ndihmojnë Kosovën dhe stabilitetin e saj. [Pamje të Dacit në zyrën e tij] [22.2]

Prezentuesi: Sulmin ndaj qytetarit serb në Çagllavicë e ka dënuar edhe kryesia e PDK-së. Çdo akt dhune shkon në dëm të proceseve demokratike dhe të përpjekjeve që po bëjnë institucionet e Kosovës për të krijuar një klimë tolerante në mes qytetarëve të Kosovës, vlerëson kryesia e kësaj partie. Ai vlerëson se bllokimi i rrugëve dhe sjellja e dhunshme ndaj kalimtarëve është veprim i dënueshëm që shkon në dëm të lëvizjes së lirë së qytetarëve. [Pamje të logosë së PDK-së] [23.5 sec.]

Lajmi i tretë: Protesta “të gjithë në mbrojtje të luftës çlirimtare”

Prezentuesi: Sot, në Prishtinë dhe në qendra të tjera të Kosovës, u mbajtën protesta paqësore me moton “të gjithë në mbrojtje të luftës çlirimtare”. Oratorët që ju drejtuan protestuesve kërkuan lirin nga burgu të eprorëve të trupave mbrojtëse të Kosovës të cilët sipas tyre po mbahen padrejtësisht.[13.07 sec.]

Prezentuesi: Valon Bajrami, gazetar i TV 21 raporton nga protestat në Prishtinë: Shoqatat e dala nga lufat si organizatore të protestës dhe qindra qytetarë të cilët protestuan para Teatrit Kombëtar shprehen edhe një herë revoltën e tyre ndaj arrestimeve të çlirimtarëve. Anëtarët e këshillit organizativ të protestës kërkojnë nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare që të mos shkilet mbi vlerat e luftës çlirimtare dhe në të njëjtën kohë ata kërkojnë lirin as më të shpejtë të eprorëve të TMK-së të cilët sipas tyre po mbahen padrejtësisht nëpër burgje.

Lufta e UÇK-se kishte vetëm një qëllim, çlirimin e trojeve tona nga pushtuesit. Ajo kishte karakter të pastër çlirimtar dhe ishte e orientuar kundër të gjithë mekanizmave të pushtuesit që për një shekull rresht bënë krime mbi popullin tonë. Kështu u tha në protestën e organizuar në Prishtinë kundër arrestimeve të pjesëtarëve të ish-UÇK-së. Anëtarët e këshillit organizativ thanë se kriminalizimi i luftës çlirimtare dhe mohimi i gjakut të mijëra dëshmorëve është krimi më i madh që mund të ndodhë sot. [pamje nga protesta paqësore] [54.5sec.]

Fragmente të deklaratave të organizatorëve të protestës:

Faton Klinaku, anëtar i Këshillit Organizativ të protestave: Shumë zhurmë po bëhet në Kosovë, në të gjitha nivelet politike, ato hetimore dhe gjyqësore. Po bëhet një zhurmë rrëqethëse, që po e vën në pozitë të vështirë dhe të padurueshme popullin që dha aq shumë gjak për të jetuar i lirë. Me qëllim që të luftohen këto vlera në shënjestër janë kryesisht ish-luftëtarë të UCK-së dhe në

tërësi lufta jonë çlirimtare. [Flet para protestuesve para Teatrit Kombëtar] [22.8 sec.]

Sadik Krasniqi, anëtar i Këshillit Organizativ:

Ku janë ato parti, ato mekanizma, ato institucione të Kosovës të cilët e lëjnë luftën, të cilat i lejnë familjet e dëshmorëve, invalidët, veteranët nën mëshirën e fatit, në udhëkryqin e Kosovës. [Flet para protestuesve para Teatrit Kombëtar] [8.3 sec]

Mustafë Sopi, Shoqatave e Familjeve të Dëshmorëve: Nuk është hera e parë që ne protestojmë në këtë mënyrë. Mirëpo, kërkesat tona as edhe një herë nuk u morën parasysh. [Flet para protestuesve para Teatrit Kombëtar] [21.4 sec]

Korrespondenti vazhdon: Protesta në Prishtinë përfundoi pa incidente dhe protetsuesit u shpërndanë në mënyrë të qetë. Protesta me moton “Të gjithë në mbrojtje të luftës çlirimtare” u mbajtën sot edhe në qendra tjera të Kosovës. [Pamje të tjera nga protesta] [09.8]

Temat e tjera të lajmeve:

- Vizita e Thaqit në SHBA dhe takimi i tij me Z. Albright
 - Jakup Krasniqi kundër Ministrit të Financave
 - Kontratat kolektive
 - Pakoja e draft ligjeve për energji elektrike së shpejti do të del para kuvendit
 - Parashikimi i motit
-

RTV 21

17 mars 2004

18:30

Lajmet kryesore**Intervista e Bahtir Cakollit me Fitim Veselin**

B.C: Këtu në këtë vend filloi tragjedia e djeshme. Fitim Veseli ishte ai që i shpëtoi kësaj tragjedie, por humbi vëllaun.

Rrëfimi i Fitimit: Ne ishim duke shetitur. Ne i kemi edhe arat tona dhe kur disa serbë me një qen dmth dy serbë na deshën të na sulmojnë, ne ishim gjashtë veta. Dy veta ishin ma përpara Florim Veseli dhe Qamil Zeqiri, ata dy shkonin dmth anës së majtë ndërsa ne jemi kan katër. Jemi shku gjithë bashkë, unë vëllau jem Florent Veseli 9 vjeç, Egzon Deliu 12 dhe Avni Veseli 11 vjeç, kur na kan sulmuar shkijet.

Ma së pari se ne nuk i kishim parë shkijet por na kan shajt prej asaj shtëpie atje [ai tregon me gisht shtëpinë nga një distancë që duket 100 metra apo më shumë] dhe tani i kemi parë na dhe kemi filluar të ikim por ata na e lëshuan qenin se ishte qeni shumë i shpejtë dhe ne nuk mund të ikim. Egzon Deliu dhe Avni Veseli hynën këtu në atë pjesën aty në lumin Ibër ndërsa unë dhe vëllau im ishim me përmas se ai nuk mundte të ngante shpejtë.

Ishim në atë pjesën atje duke zbritur poshtë pra ishte lumi deri aty, shumë i madh dhe valët ishin shumë të shpejta. Unë kur dola këtu njëherë më ra nga shpina, këtu siç thash edhe më parë dhe shkoi tri katër metra tani unë notova shpejt dhe e zura apet. Ndërsa ata të dy tjeret kur kemi dal unë dhe vëllai im këtu ata të dy tjeret veçsa shkuan ma përpara se na.

Egzon Deliu dhe Avni Veseli se ishte libri shumë i shpejtë, ata notojshin dhe ne kur e qita në shpinë shkova në uje deri atje, dhe mua më qiti ujët 20 metra prej këtushit, a ma shumë, 30 (m) qatje më qiti dhe kisha pirë uje po s'kisha pirë uje shumë dhe pastaj kqyra, u qova kur me erdh pak fuqia, kqyra nashta pe shoh najnjanin po nuk e pash asnjë.

Tani shkova te një djali i mixhës, te Driton Veseli, e ka shpin qatje, shkova e i tregova qysh ke rasti. Tani e lajmeroi policinë, KFOR-in TMK-në, e kshtu të tjerë, dy i kan gjetë.

[Përderisa fliste tregonte vendin e përmendur në tekst] [2 min e 30 sec]